

SAŠA ILIĆ
QENI DHE KONTRABASI
ROMAN

BOTIMET TOENA

Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria Federale e Evropës, Integritetit dhe Punëve të Jashtme në Republikën e Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni Zvicëran Pro Helvetia, Grupi i Interesit të Përkthyesve dhe Përkthyesve (Shtëpia e Letërsisë Vjenë) me porosi të Ministrisë Federale të Artit, Kulturës, Shërbimeve Publike dhe Sportit në Republikën e Austrisë, Instituti Goethe, Agjencia Sllovene e Librit, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe Informacionit e Republikës së Serbisë, Ministria e Kulturës e Rumanisë, Ministria e Kulturës e Malit të Zi, Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Kulturës e Republikës së Bullgarisë, Panairi i Librit në Lajpcig dhe Fondacioni S. Fischer.

TRADUKI

SAŠA ILIĆ

QENI DHE KONTRABASI

roman

Përktheu nga serbishtja Ben Andoni

Botimet Toena

Autori: Saša Ilić
Titulli në origjinal: Pas i kontrabas

Botuese: Irena Toçi

Redaktor: Eris Rusi
Korrektore letrare: Sonila Kryeziu
Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj
Kopertina: Gea Qëndro

ISBN 978-9928-960-19-1

© 2019 Saša Ilić
© 2025 në *shqip* BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. “M. Gjollesha”, K. Postare 1420, Tiranë
Tel.: + 355 4 22 40 116
Email: botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al>

Don't play what's there. Play what's not there.

MILES DAVIS

**Çdo ngjashmëri me ngjarje historike, personazhe
dhe kafshë, është e rastit.**

I.
REVOLUCIONI I SHKURTIT

Kovin, mars 2016

Dimri i atij viti erdhi me shumë akull, që mbi shpinën e Danubit, pas kalimit të akullthyesve hungarezë, të bënte ta mendoje si ndërrimi i lëkurës së gjarprit: ndërkohë uji i errët gjelbëran shpërtheu përgjatë çarjeve të akullit, duke shkumëzuar anash anijes patrulluese, nga kuverta e së cilës unë dhe shoqëruesi im Brdari po këqyrnim heshtazi hapjen e rropullive të lumit në një brazdë të gjerë. Pirgje me luspa akulli notonin rreth skajeve të saj. M'u faneps sikur pashë figura njerëzore në lëvizje mbi njërën nga to, mbështetur në mënyrë të pasigurt mbi shkopinjtë të gjatë, të cilat e tejkalonin shumë lartësinë e tyre. Pas kodrinave të akullta dridhmonin pyjet e rënduara me borën bregdetare dhe qielli pothuaj sa nuk po u shembej përsipër. Motori gulçonte herë pas here, ndërsa anija villte dy rryma të forta uji në lumë si të dala prej rropullive të një balene, ndërkaq bashi i kuvertës shtyhej përpara duke iu hipur masave të akujve të pathyer. Fill pas kërcitjes së çuditshme të akullit, anija do të plandosej sërish në nivelin e zhytjes dhe, kështu do të bënim edhe ne, duke vazhduar lundrimin drejt Kovinit, limanit të Danubit, ku, sipas fjalëve të Brdarit, po na priste enkas një makinë shërbimi. Ai vetë po qëndronte i mbështetur në këmbë te parmaku i kuvertës tendosur me kablllo dhe nuk ndaloj së tymosuri duhan qysh nga Beogradi. Nga spazmat që i vëreheshin në fytyrë qartësohej se këtë herë po e kalonte vështirë udhëtimin. Ishte një tip i lidhur ngushtë me tokën,

andaj çdo përkundje e anijes ia ndryshonte krejt qendrën e gravitetit në stomak. Të tillë pashë shumë kohë më parë, ndërsa lundroja me anijet e Marinës ushtarake Jugosllave, pa dyshuar se një ditë ecja mbi kuvertën e trazuar do të përbënte angazhimin tim kryesor në jetë.

Në fakt, të ecësh mbi kuvertë dhe të luash xhaz ka shumë gjëra të përbashkëta. Asnjëherë nuk ndodh në të njëjtën mënyrë dhe kurrë nuk tingëllon me të njëjtin tonalitet. Ecja e marinarëve, gjatë stuhisë, veçanërisht atyre të shëndoshëve, mund t'i kujtonte dikujt veprën "*Giant Steps*" të Coltrane-it¹. Apo të Miles tek "*So What*". Ecja e zakonshme por e paqëndrueshme në fund të natës mbetej më e besueshmja nga të gjitha. Dikur më pëlqente të përsiatja për ato lidhje të pamundura midis xhazit dhe botës përreth. Mendoja shpesh se mund të arrija ta shprehja gjithçka me instrumentin tim, madje edhe tingullin e kërcitjes së akullit nën anije, thirrjen e njerëzve në breg, po qoftë edhe fytyrën e parruar dhe të çrregullt të Brdarit, mbuluar me brymë. Kushedi se çfarë po mendonte teksa lundronim. Tipa të tillë gjithmonë i vajtonin ritualet e humbura mikroborgjeze, ato drekat familjare, shtratin e rehatshëm, ndonjë shkuarje në pikën e basteve, ikjet për birra, e deri arratinë e beftë te dashnoret. Kishim diferencë prej dhjetë vjetësh, por ndoshta edhe më shumë. Brezi i tij arrinte të kujtonte disa kohë më të mira në Beograd. Ai pa dyshim nuk mund të arrinte e të mendonte jashtë sistemit, ndërsa shumë bashkëmoshatarë të tij e kishin

¹ John William Coltrane ishte saksofonist amerikan i xhazit, udhëheqës bande dhe kompozitor. Ai është ndër figurat më me ndikim dhe më të vlerësuara në historinë e xhazit dhe muzikës së shekullit XX.

kuptuar prej kohësh. Në fakt, disa prej tyre sajuan ndonjë biznes privat, si p.sh. bënin sandale apo gjëra të ngjashme pa lidhje, të tjerë drejtonin ndonjë rrjet zhvatjeje ose ndonjë klub nate, ku unë luaja me F-kuartetin tim. Gjatë këtyre viteve të vështira, ata mësuan sesi t'i shfrytëzonin njerëzit dhe t'i konsideronin madje si diçka të zëvendësueshme dhe të shpenzueshme për të cilën nuk kishin pse të pendoheshin. Të paktën në Beograd kishte ende material të tillë njerëzor. Edhe nëse nuk do të luaja unë, atëherë do të ishte dikush tjetër. Dhe, në fund të fundit, mbijetuan ata që nga lufta dhe fatkeqësia njerëzore nxirrnin vetëm fitim: *Range Rover*-at e tyre lëviznin pa kokëçarje rrugëve të Beogradit, pa denjuar të jepnin as edhe një lloj shenje sinjalistike ose duke mos iu bindur asnjë lloj rregulli, ndonjëherë duke vozitur madje edhe në drejtimin krejt të kundërt me rregullat e qarkullimit. Bërdari sigurisht që nuk ishte njëri syresh prej tyre. I përkiste asaj shumice të qetë që e kaloi jetën duke respektuar rregullat pavarësisht kësaj hullie: paguante në kohë energjinë elektrike dhe taksat, i respektonte shefat dhe ishte i përkushtuar ndaj shenjterisë së orarit të punës. Me gjasë i kishin mbetur edhe pak miq nga shkolla e mesme, me të cilët takohej fundjavave ose gjatë ditëve të derbit të futbollit, kur ata së bashku konsumonin një sasi alkooli më të madhe se zakonisht apo i dorëzoheshin ritualit të tifozllëkut. E shoqja duhet të kishte qenë krejtësisht ndryshe nga ai, sepse ishte e vetmja që mund të bashkëjetonte me këtë krijesë të tipit alla Bërdar që më shoqëroi në detyra zyrtare. Në xhep kishte një urdhër specialisti nga AUS¹-ja, nga ku mua më liruan

¹ Akademia Ushtarake Sanitare. (*Shënimet në tekst janë të përkthyesit*)

pas katër muajsh të gjatë, duke më përcjellë në Njësinë e Rehabilitimit të Veteranëve, e cila ndodhej si njësi brenda Spitalit të Specializuar për Sëmundjet Psikiatrike në Kovin.

Anija patrulluese e gjelbër ishte e mbuluar në disa seksione gjeometrisht edhe me ngjyrën rozë, kryesisht përgjatë saldimeve ku bashkohej veshja me kallaj. Në ato vende, një sy me përvojë mund të kapte mbetjet e bojës gri, që dikur përbënin shenjën dalluese të Flotës Detare Jugosllave. Me sa duket, pas luftës, këtë anije e transferuan mbi Danub në të ashtuquajturën flotilje lumore që shërbente për gjithçka dhe për çdolloj gjëje, por në shumicën e rasteve për paradat që do të mbaheshin herë pas here. Kisha një mik, piktorin Terziq, i cili në fillim të viteve nëntëdhjetë shërbeu me mua në të njëjtën anije. Ai ishte një djalë i gjatë, jo i përshtatshëm për atmosferën e luftës së atyre ditëve. Ndërsa prisnim transferimin mbi një barkë në Tivat, e shihja shpesh duke medituar i mbështetur mbi parmakun rrethues në kuvertë. Ndonjëherë flisnim për dështimet tona, për të shtënat nga Prevlaka, por edhe për John Lee Hooker¹ dhe albumin e tij *The Healer*, i cili na lidhte së bashku nga pasioni. “Do të arrij ta bëj diçka të tillë ndonjë ditë, - më tha njëherë, - nëse do t’i mbijetoj të gjithë kësaj. Do ta bëjmë së bashku”, - shtoi dhe, pas kësaj nisëm të duartrokisnim së bashku, duke i shtrënguar fort gishtat e mëdhenj si të ishin hallka zinxhiri. Shumë vjet më vonë e hasa përpara Kolektivit Grafik në qendrën e Obiliqit. Ai ishte bërë

¹ John Lee Hooker ishte këngëtar, kompozitor dhe kitarist amerikan i muzikës blues. Bir i një fshatari, ai u bë i famshëm duke performuar një adaptim në stilin e kitarës elektrike të muzikës Delta Blues, të cilin e zhvilloi në Detroit.

tashmë piktor dhe ndërkohë po shpërndante fletëpalosje që njoftonin ekspozitën e tij. “Terziq!”, - e thirra. Kur u kthye, për një çast iu ndie një buzëqeshje e ashpër, por pastaj u përqaftua ngrohtë. Më erdhi mirë që e pashë. “Je ende i gjallë”, - më tha ndërsa po preknim njëri-tjetrin në supe. “Ja ashtu”, - iu përgjigja me një buzëqeshje. Nuk kishte ndryshuar aq shumë, vetëm që syzet të cilat mbante tani e bënë të dukej më serioz. Ia pashë fletëpalosjen dhe u mahnita nga portretet e Koraqit, Kiçanoviqit dhe Gjorgjeviqit¹ me veshjet e sportit. “Çfarë është kjo?” - e pyeta. “Ekspozita ime e parë profesionale”, - m’u përgjigj. “Nga të erdhi si prirje basketbolli?” “Bota po ndryshon”, - ma ktheu, - dhe basketbolli sot përbën një stërvitje të shkëlqyer mendore për një artist...” “Pasnesër, mund të jetë pasarelë mode”, - shtova unë. “Dhe kjo tashmë *passé*, o plak”, - qeshi dhe shtoi se do të donte shumë të më shihte ta vizitoja në atë ekspozitë. I premtova se do të shkoja, por, në fakt, nuk munda. Ndoshta kisha ndonjë koncert, apo ndoshta ishte vetëm një justifikim.

“Kemi mbërritur”, - m’u duk sikur tha Brdari kur anija patrulluese filloi të lëkundej përpara një seksioni të ngrirë të Danubit. Para nesh në kursin tonë na qëndronte si pengesë një shkëmb i madh rëre, i lëmuar si qelqi. Më tej nuk ishte e mundur të vazhdohej. Kapiteni i anijes doli nga kabina dhe na tha diçka, duke u përpjekur ta mbyste disi gulçimën e motorit. Brdari vetëm sa pohoi me kokë. Disa njerëz me uniformë po lëviznin andej-këndej mbi breg. Sipër në dok, mund të dallohej sipërorja e furgonit të policisë. “Shpresoj

¹ Ish-lojtarë të njohur të përfaqësueses të ish-Jugosllavisë në basketboll.

që ky automjet zyrtar nuk po pret për ne”, - i shtova nga pas Brdarit, i cili tashmë po ngjitej mbi shkallën metalike. Anija patrulluese u qetësua, por ishte ende e vështirë të hidheshe poshtë. Mund të ndodhte që akulli të thyhej dhe anija të zhytej në ujë. Dy marinarë me uniforma kamuflazhi dhe jelekë portokalli të shtrënguar fort rreth belit kishin lidhur litarë me parafango të mëdhenj në të cilët depërtonin ende copa të mprehta akulli. Brdari u hodh tutje i bindur kur komandanti i dha një shenjë me dorë, ndërkohë që unë ngurrova për njëfarë kohe. Së pari, flaka çantën e udhëtimit mbi akull dhe, pastaj shtrëngova kutinë me kontrabasin dhe qëndrova i stepur derisa të gjeja momentin e favorshëm për t’u hedhur. Kuverta lëkundej lart e poshtë, uji ngrihej lart pareteve të anijes dhe tërhiqej poshtë nën akull, ndaj Brdari u acarua. Duke parë se nuk do të guxoja aq shpejt, një marinar m’u afrua nga pas dhe më kapi nga supet, dhe në momentin kur kuverta ishte në pikën më të ulët, më shtyu mbi akull si të përbëja një ngarkesë të tepërt. Rashë mbi gjunjë dhe mbi shputa, kurse kutia rrëshqiti pak larg meje. Ndërsa po rregulloja mbi krye kapelën, pata përshtypjen se masa e madhe e borës po shpërbuhej ngadalë nga anija e palëvizshme. Dukej sikur Amundseni dhe Nobile¹ po zbarkonin në Polin e Veriut dhe jo në Kivinin e Danubit. Një tufë pulëbardhash lumi fluturuan sakaq lart, të frikësura

¹ Roald Amundsen dhe Umberto Nobile ishin eksplorues polarë që bashkëpunuan në ekspeditat pioniere të aerostateve në Polin e Veriut. Amundsen, eksplorues norvegjez, ishte i pari që arriti në Polin e Jugut duke lundruar në Shtegun Veriperëndimor. Nobile, një inxhinier italian, projektoi dhe pilotoi aerostatet e përdorura në këto ekspedita, duke përfshirë "Norge" dhe "Italia".

nga manovrimi i anijes patrulluese që po lundronte me gjithë fuqinë drejt lumit. Kursi vazhdoi përpara drejt Tekijës dhe Kladovës, siç dëgjova nga Brdari. Me sinjalin e tij, e vendosa kutinë e kontrabasit mbi shpinë, mora çantën e udhëtimit dhe e ndoqa pas. Meqenëse ishte e pamundur të ecnim, ne rrëshqitëm drejt bregut, duke zgjedhur një shteg të rastësishëm mbi akullin që rrezikonte të çahet nën këmbët tona.

Mendova shumë për lumin, si edhe për trupin e gjelbër masiv të Danubit që na këqyrte përmes lentave prej kristali akulli. Duhet të dukeshim si të shpërfytyruar, me patjetër do të mund ta frikësonim dikë me pamjen tonë. Dhe ndoshta ky ishte portreti më realist i ne të dyve. Buzëqesha kur mendova se si dukej fytyra e trishtuar e Brdarit nga poshtë. I imagjinova tufat e peshqve nën akull që po na ndiqnin në heshtje. Me gjasë, disa prej tyre po prisnin krisjen e akullit dhe rënien tonë. Ishte pa dyshim më ngrohtë atje poshtë: jeta në lumë rridhte paqësisht, e vetmja gjë që mungonte ishte ushqimi. Mund të bëheshim mbase ne të dy ushqim i mirë: oficeri i ushtrisë, Brdari, dhe unë. Nëse akulli do të thyhej, rryma do të na tërhiqte gjithnjë e më larg nga vrima nëpër të cilën do të përthitheshim. Për një moment do të shpërbleheshim me atë pamje nga poshtë dhe do ta shihnim botën në realitetin e saj, ashtu siç po e kundronin tashmë vetëm peshqit.



Trupi i gruas së re me pizhame spitali, mbështjellë me një mantel të grisur, nga i cili dilnin barëra të përdredhur lumi, ishte shtruar mbi një fletë tende kamuflazhi. Flokët e saj të gjatë zijosh, të gërshetuar, rrezatonin në drejtimin nga ku po e zvarrisnin nëpër dëborë. Dy policë dhe një burrë më i ri, me sa duket inspektor me rroba civile, qëndronin të painteresuar pranë saj, e ky i fundit nuk i ndahej telefonit kohë pas kohe. Kur iu afruam sa ishim fare pak metra larg atyre brenda fare pak metrash, ne instinktivisht ndaluan, duke mos ditur se çfarë të bënim. Në fakt, po ndiqja Brdarin dhe bëra të njëjtën gjë si ai. Por këtë herë, ky e gjeti veten përpara një enigme që nuk mund ta zgjidhte dot vetë, kështu që thjesht u ndal dhe e vuri kapuçin mbi kokë, duke menduar se po fshihej nga problemi. Polici i madh me shpinë të përkulur picërroi sytë kur na dalloi dhe, pastaj u kthye nga tjetri duke i pëshpëritur diçka. Inspektori eci pa qëllim dhe i tregoi dikujt për atë që kishte gjetur tek trupi i vajzës nga Instituti i Rehabilitimit, e cila ishte mbytur mbrëmë në Danub. E dëgjova të përmendte disa pacientë të tjerë që u gjetën në afërsi të Kovinit, teksa tre syresh u kapën në restorantin “Utva” jo shumë larg stacionit të policisë. Ai tha pikërisht këtë, *u kapën*, sikur të ishin kafshë të arratisura prej kopshtit zoologjik. Këqyra në drejtim të kufomës; m’u duk se vajza kishte tipare jashtëzakonisht të rregullta të fytyrës dhe vetulla të errëta e të bashkuara, e ku ta dish mbase ishte shtatzënë. Ajo kishte një bark të vogël, që i jepte trupit të saj të tonifikuar një pamje paksa të tendosur. U afrova edhe disa hapa më afër, doja ta fiksoja

më qartë, por dora e një polici më bllokoi me një goditje në gjoks. “Ku po shkon?!” - më bërtiti. “Ndalo, - tha Brdari sikur të ishte zgjuar nga një ëndërr, - jemi me shërbim këtu.” “E ç’më duhet, - tha polici pa e hequr dorën nga gjoksi im, - s’e shikoni se çfarë po ndodh këtu?” “Ne do të shkojmë në Institutin e Rehabilitimit”, - tha Brdari, duke i zgjatur urdhrin e udhëtimit. “M’u zhduk nga sytë”, - ia ktheu polici me tërbim, por në atë moment shefi i tij e ndërpreu bisedën dhe na u afrua. Inspektori Bozhoviq u prezantua në formë rutinore dhe na pyeti: “Po ju kush na jeni? Oh, shumë mirë, do të shkon në të njëjtin vend”, - shtoi pasi pa dokumentin e Brdarit. “Çfarë ka ndodhur?” - ia doli të fliste Brdari. “Një grup pacientësh ia mbathi në mbrëmje nga Instituti dhe ja shiko, t’ia dhjesh atë se çfarë po ndodh...”, - tha inspektori duke treguar me kokë në drejtim të trupit të pajetë. “Ajo u mbyt...”, - tha Brdari me zë të ulët, sikur të thoshte “Është mot i ftohtë” ose “E tillë është jeta”. “Po, ajo u mbyt... Tani m’u hiqni sysh që këtej!”

Brdari mezi po e priste atë urdhër. Nuk munda ta mbaja ritmin e hapit të tij ndërsa po përparonte përgjatë shtegut në dëborë drejt një kamionçine të vogël e të bardhë “Zastava” me një shenjë të Kryqit të Kuq në derë. Shoferi, i mbështjellë me një shall dhe me kapelën e zhytur deri te sytë, vetëm sa pohoi me kokë kur Brdari i tha diçka përmes dritares. Ai u përpoq ta ndizte makinën, por nuk funksionoi, kështu që na dha shenjë t’i jepnim një dorë duke e shtyrë. Karrociera po dridhej kur e nisëm. Brdari, ndërsa po vepronte kështu, rrëshqiti dhe ra, duke u rrokullisur përmbys si të ishte një lastar i ngathët që vazhdonte të luftonte me motin. E vëzhgova disa momente duke menduar se çfarë të bëja. Do

të preferoja ta lija atje dhe të nisesha i vetëm drejt Institutit, por buria e ngjirur e kamionçinës më bëri t'i ngrija dorën. “Çfarë jete muti!”, mallkoi Brdari ndërsa pastronte borën nga bërrylat dhe shpatullat. Ishte e qartë se po i shkonin shumë gjëra në kokë. Ai as nuk mund ta ëndërronte t'i shtohet një ditë e tillë jetës së tij të mjerë. Më shikoi me qortim dhe u ul në vendin e pasagjerit, kurse unë u ula në sediljen e pasme duke vendosur gjërat e mia. Shoferi e rrotulloi me këmbëngulje makinën, gjë që bënte në fakt që gjithçka të dridhej. Brdari nisi të shpjegonte diçka pa nevojë, por pastaj shoferi lëshoi freksionin, gomat kërcitën mbi akull dhe pas një sforcimi të shkurtër u nisëm. As nuk e vura re kur ra errësira e parë. Në dritën që lëshonin fenerët, dallova borën që po binte dhe automjeti rrëshqiste herë majtas, ose në të djathtë në një rrugë të ngushtë rrëzë kreshtës së bardhë nga e cila shquhej ngrehina e një lloj hoteli. Dekorimet e Vitit të Ri qëndronin ende të varura mbi dritaret e mëdha në sallën e një restoranti.

Shpejt, shtëpitë e ngushta mbaruan, kurse nga ana jonë e majtë na rrëshqiti në pamje një gardh i gjatë me shtylla të veshura me tulla, fiksuar me shufra hekuri të farkëtuara. Ky ishte pra kompleksi i spitalit special: i vendosur midis pemëve, teksa vargëzonin pavijone austro-hungareze të vjetra, të cilat nganjëherë zgjeroheshin. Drita në dritare ishte e dobët, asgjë nuk ishte e dukshme në brendësinë e errët. *Pick-up*¹ ndaloi përpara një porte metalike me shtylla të stërmëdha, në të cilat ishin të vendosura dy amfora në disa si kamare. Ato ngjanin me urna të lashta. Më në

¹ Tip kamionçine

fund, pasi portieri hapi portën hymë në hapësirën e spitalit. Kamionçina u kthye djathtas pas një ndërtese të ndriçuar mirë, ku në një parking hasëm një makinë *Peugeot* të policisë. “Përsëri ata”, - mendova, duke parë nga Brdari. “Ja ku jemi, më në fund”, - e dëgjova shoferin duke folur pasi e fiku motorin.

Në të kaluarën, dyshemeja e ndërtesës së pritjes do të kishte qenë e shtruar me kombinimin e fushës së shahut të pllakave të gjelbra dhe të bardha, por tashmë kjo mund të shquhej vetëm në qoshet, ndërsa pjesa më e madhe e korridorit ruante nuancat e ndryshme të së njëjtës ngjyrë të ndyrë. Kutërbonte erë kimikatesh dhe thartire, origjina e së cilës nuk mund të kuptohej prej meje. Qysh sa hyra brenda, e nuhata atë kutërbim; pata përshtypjen se nuk do të çlirohesha më kurrë prej saj. Kurse Brdari nuk ngeci, gjithçka ishte fare normale për të, si pjesë e shërbimit të përditshëm, ai thjesht ndoqi në heshtje udhërrëfyesin tonë, i cili na hoqi udhë shkallëve drejt katit të sipërm.

Në fund të korridorit të ndriçuar zbehtë dallova një stol pranë murit dhe mbi të qëndronin disa njerëz ulur krejt ngjitur pranë njëri-tjetrit. Ata i mbanin duart e shtrira përpara. Vetëm kur iu afruam, kuptova se kyçet e duarve i kishin me pranga. Në fund të këtij rreshti të errët, nga i cili kohë pas kohe shkëlqenin vetëm të bardhat e syrit, qëndronte një polic i armatosur. “Ku shkoni?”, - pyeti me qetësi kur iu afruam. “Tek doktoresha Sibinoviç, - tha drejtuesi ynë, - kemi një të ri këtu.” “Doktoresha është e zënë, - paralajmëroi oficeri i policisë, - duhet të prisni pak”. “Mirë, mirë,” - murmuriti shoferi dhe pastaj trokiti në derë.

Nga brenda dëgjohej një rrëmujë, një zë i thellë mashkullor, që derdhej n'ajri krejt i paqartë, na mbërriti sakaq, për të vazhduar me një goditje xhami dhe hapat e shpejtë drejt derës. Instinktivisht u tërhoqëm prapa dhe vazhduam të presim. Dera u hap papritur dhe nga brenda na u shfaq një plak i gjatë, jashtëzakonisht vital, me një rrobë me vija, duart e të cilit, nga prapa, mbaheshin nga dy infermierë të mëdhenj me kësula të rrumbullakëta, të ngjashme me ca si enë të përmbysura. “Nuk do të më thyesh, doktoreshë!” - bërtiti plaku duke e kthyer kokën, por kur infermierët arritën dhe e shtynë përmes derës që lëshoi një gërvimë të thellë, ai arriti të shkëputej prej tyre dhe përshkoi me qetësi korridorin pranë nesh. Edhe pse nuk ia dallova fytyrën për shkak të dritës që vinte nga dhoma e mjekes, arrita ta shquaja ecjen e tij elegante, kundrejt të cilit infermierët ngjanin me njerëz të çoroditur. Por liria e tij nuk zgjati shumë, sepse shpejt u mbërthye nga një polic dhe me dy lëvizje rutinë iu mbërthyen prangat. “*Selvaggio*”, tha plaku me qetësi dhe zuri vend në të vetmin vend të zbrazët në stol. Krijesa e vockël pranë tij pordhi zhurmshëm, dikush buzëqeshi dhe polici nxori shkopin dhe goditi fare rastësisht pacientin më të afërt. “E po, mirë, po pse gjithmonë në, drejtin?” - u ankua pacienti. “Qepe aty!” - ia ktheu polici.

Dhoma e mjekut ishte ndryshe nga çdo zyrë tjetër ku kisha qenë më parë. Më kujtonte më shumë mjedisin e një biblioteke ose një arkiv të lashtë. Kapa tavanin e lartë, raftet të mbushura plot me fashikuj e dosje dhe, në mes: një tavolinë të gjerë me një glob të madh dhe një kompjuter *Apple*. Pas monitorit të madh rrinte e ulur një grua me syze të rrumbullakëta që i pasqyronin *desktop*-in: imazhi i një

shkëmbi të kuq me gjuhën blu qiellore sipër saj. Shoferi iu afrua në heshtje dhe i vendosi letrën e Brdarit mbi tavolinë. Ajo u çua menjëherë shpejt dhe e shtyu karrigen, e cila u rrokullis me zhurmë në parketin e paniveluar. Kur na u afrua, për herë të parë ndjeva aromën e parë të këndshme në këtë botë, përtej portës me urna. Ajo vinte e shkurtër në trup, i kishte të lidhur flokët bishtkali dhe uniforma e saj e gjelbër dhe e çelët ishte paksa e shtrënguar në gjoks, fakt që e kapa kur bëri një lëvizje të papritur. E mati me sy Brdarin dhe i tha: “Ah, ju jeni ai Filip Isakoviqi, po supozoj.” “Ah, jo, jo, - belbëzoi ai, - nuk jam unë, doktoreshë...” “Apo jeni ju?” - e korrigjoi veten ajo në një çast, duke u kthyer nga unë. Mund t’ia ndieja qartë shikimin e ftohtë që po më skanonte përmes lenteve të syzeve. Po ndihesha në siklet, kështu që këqyra mbi të në murin mbi të cilin varej një poster me fazat evolucionare të zhvillimit njerëzor. Në etapa, krijesa e përkulur si majmun drejtohej gradualisht, pastaj humbi qimet, u zbut me kthesat e lëmuara të kafkës, kështu që përfundimisht ky serial mbaronte me një burrë të zhveshur e të shëndoshë që po qëndronte përballë së njëjtës lloj grua. Dhe përsëri, linja femërore shkoi prapa, nëpër të gjitha fazat evolucionare, derisa u zhduk. “Po, unë jam,” - thashë, duke liruar rripin prej kutisë të kontrabasit. “Dhe ju... ju, jeni muzikant,” - shtoi doktoresha. “Po”, - u përgjigja, por shpejt e korrigjova veten duke thënë se në fakt isha dikur. “Çfarë doni të thoni me ishit?” - pyeti duke prekur qafën plastike të kutisë me habi. “Kështu, ja si të të them, nuk luaj shumë, - iu përgjigja, - harrova si ta luaja më instrumentin...” Doktoresha më shikoi me kuriozitet dhe pastaj shtoi se do t’i analizonim së bashku të gjitha këto.

“Kjo do të më ndihmonte të ktheja instrumentin tim.” Brdari u përpoq të thoshte diçka, por shikimi i saj i shtrembër e bëri të heshtte sakaq. “Patëm një situatë të jashtëzakonshme në Institut”, - tha doktoresha Sibinoviqi ndërsa u kthye në karrige dhe iu afrua tavolinës. E pashë përsëri reflektimin e shkëmbinjve të kuq në lentet e syzeve të saj. “Fatkeqësisht, kjo çështje përfundoi me një vdekje... Pacientja jonë, emigrante, fatkeqja Asja Alasaf, u gjet në Danub... E mbytur... Kjo është arsyeja pse policia është këtu dhe do të hetojë gjithçka... Do të kthehem shpejt në normalitet, ndoshta brenda një ose dy ditësh.” “Çfarë ndodhi?” - e pyeta. “Ah, çfarë, - tha doktoresha, - pra çfarë, po ja ato gjëra që ndodhin zakonisht në institucione si këto... Disa nga pacientët menduan se mund t’i zgjidhnin problemet me një rrugë të shkurtër dhe kjo është ajo çka morëm në fund si rezultat.” Një trokitje na e ndërpreu bisedën dhe në derë u shfaq inspektori që hasëm në brigjet e Danubit. Ai e hoqi kapuçin e mbledhur, na këqyri fillimisht dhe pastaj iu drejtua doktoreshës: “Do të na duhet të flisnim vetëm për vetëm...” “Sigurisht,” - iu gjegj ajo dhe i bëri shenjë shoferit të më nxirrte jashtë. Ndërsa po largoheshim, e dëgjova t’i thoshte se “...E gjitha kjo është shumë më tepër serioze se çfarë po mendonin ata.” Ndërkohë, polici dhe pacientët e kapur e lanë korridorin. Me ta mbeti vetëm aroma që ndjeva qysh në hyrje. Brdari më shikoi dhe murmuriti diçka. E kuptova se donte të përshëndetej me mua. Dora i mbeti aty në ajër për një kohë të gjatë. Kur ia cika dorën, ndjeva të ftohtë të butë nga e cila më përshkuan të dridhura. “Do të kthehem sërish nesër në mëngjes,” - tha Brdari. “Unë do të rri”, - e detyrova veten të buzëqeshja. “Ti rri dhe këndo, -

më përqeshi shoferi pas shallit, të cilin nuk e ndau për as edhe një çast nga goja, - le të kalojmë tek triazhimi¹ tani”. Brdari ia zgjati dosjen time shëndetësore dhe eci ngadalë përgjatë korridorit. Çapitej i qetë si pas një pune të bërë mirë. Tani mund të pushonte diku në katin përdhes dhe në mëngjes të priste trenin e parë që ta çonte për në Beograd. Duhet të ishte i lumtur që nuk do të më shihte më kurrë, sepse e dinte qysh më parë se, sapo të hynte brenda këtyre mureve, nuk do ishte më aq e lehtë për të dalë. Në fund të fundit, ngjarja para nesh, ku ishim dëshmitarë, fliste në mbështetje të kësaj logjike. Liria ishte për pacientët, kurse fatkeqja Asja Alasafin, siç tha dr. Sibinoviqi, përbënte një gjë të paautorizuar. Për shkak të këtij mendimi u shemba në një bankë. Rripi mbi të cilin ishte varur kutia me kontrabasin më rrëshqiti nga dora. Në fund, instrumenti pozicionohej shtrirë përtokë para këmbëve. E këqyra si të ishte një gjë e panevojshme, ashtu siç më dukej këtë e tutje edhe vetja ime. E kisha zvarritur kudo për të gjithë jetën. Ndoshta kish ardhur koha të ndaheshim. Kisha vetëm frikë se do të kthehej përsëri tek unë si ai gur që shtyhet pas shkëmbinjve të kuq, por kurrë nuk arrin te maja, nga ku e hedh pamjen drejt blusë së detit.

¹ Fjala "triazh" (nga folja franceze "trier", për të renditur) përfaqëson procesin e klasifikimit të pacientëve në grupe të ndryshme prioritare, në varësi të ashpërsisë së sëmundjes ose dëmtimit të tyre. Për të realizuar triazhin u formuan peshoret e krijuara në bazë të hulumtimit.



Pothuajse kurrë s'kam pasur *polucione*¹ nate, por mbase kjo është edhe arsyeja pse shpesh më mundonte një dhimbje koke që më bënte të arratisesha në errësirën e dhomës sime për ditë me radhë. Migrena më sfiliste tmerrësisht, gati me nxirrte nga shinat dhe më bënte të pandjeshëm ndaj ndikimeve të jashtme, deri stuhia do të kalonte por pas disa ditësh rresht. Ndonjëherë më ndodhte gjatë turneve si atëherë në Lviv, ku mbërritëm me tren nga Kievi, pak para ngjarjeve në Maidan dhe luajtëm në shtatë qytete evropiane, Split, Budapest, Maribor, Grac dhe Krakov. Ishin ato net të gjata, kaluar në vagonin e gjumit me ngrohjen e padurueshme dhe batanijen e ndyrë mbi të cilën ndieja se diçka zvarritej, ku më filloi vlimi në tëmtha. E njihja atë simptomë më herët, sesi shfaqej befas nga askundi dhe pastaj të rritej deri në atë pikë sa nuk mund ta duroja më dhimbjen. Zbrita nga krevati i sipërm dhe dola rastësisht jashtë kupesë në vagon, hapa dritaren dhe nxora kokën jashtë në freskinë që më depërtoi deri në thellësi të sinuseve. Hapa sytë për të parë nga ku po vinte ajri që ma mpiu dhimbjen për një çast: dallova bardhësinë e gjerë dhe të brishtë të pyllit të mëshateknës, e cila shkëlqente nga errësira si një pararendëse e agimit. Ato pemë që lëviznin pranë meje u rreshtuan si telat në kontrabasin e madh të natës, muzikën e të cilit pothuajse mund ta dëgjoja. Më solli

¹ (Mjekësi) Flitet për një fenomen fiziologjik mashkullor, një emetim i pavullnetshëm i spermës, që ndodh gjatë gjumit, shpesh i shoqëruar me ëndrra erotike.

ndër mend një performancë të Lars Danielsson¹ në klubin vjenez *Porgy & Bess*, kur ai realizoi në instrument atë që i bën disa koncerte të mbeten të paharrueshme. Ishte versioni i këngës “*Hallelujah*”. I shoqëruar nga kontrabasi i tij, Larsi e luajti seksionin hapës ngadalë, duke bërë pauza sikur ta kishte harruar vazhdimin e partiturës, por pastaj muzika vazhdoi krejt normal. Ai luante i përpirë i tëri me fytyrën, duart, shpatullat, bërrylat, gjunjët dhe, për një çast, u trazua heshtja nga prapaskena. Kështu edhe pylli i thuprës prodhoi melodinë e duhur në trurin tim, duke e detyruar migrenën të tërhijej pak para Lvivit, të cilit po i afroheshim bashkë me gjëmimin e rrotave të trenit mbi shina. E kalova ditën në dhomën e hotelit me grilat e ulura, i pamundur për të luajtur në shfaqjen e mbrëmjes. Ivani, saksofonisti ynë, më vizitonte çdo një orë, jo për të parë si isha, por për t’u siguruar që vërtet s’do të isha në gjendje të luaja. Nuk arrija dot as të dilja nga dhoma, edhe pse kisha konsumuar një tabletë oksikodine² që nuk e ndaja nga vetja. Ivani telefonoi si zëvendësues Balázs Horváth-un, basistin e kuartetit hungarez që do të luante të nesërmen, ndërsa më pas i dërgoi një *e-mail* mikut tim Mathias, menaxherit të turit, duke iu ankuar se nuk mund të vazhdonte më kështu dhe se ai do të mblidhte plaçkat dhe do të kthehej qysh herët në mëngjes në Beograd. Kjo ishte ajo që më tha perkusionisti ynë Grujiqi

¹ Lars Danielsson (1958) është një basist suedez i xhazit, kompozitor dhe producent muzikor.

² (Mjekësi) Oksikodona, e shitur nën emrin e markës Roksikodon dhe OksiKontin ndër të tjera, është një opioid gjysmë-sintetik që përdoret për trajtimin e dhimbjeve të lehta deri në të forta.

në mes të natës, duke më zgjuar nga vdekja. Nuk mbaj mend se çfarë më tha realisht, por kuptova se Ivani kushedi se nga u tërhoq për të njëqindtën herë me disa lëvizje të rastësishme që vunë në pikëpyetje jo vetëm turneun, por dhe mbijetesën e bandës. Nuk e di si arrita dhe u ngrita nga shtrati atëherë, por dhimbja u shndërrua në dytësore, sepse mendoja vetëm për atë që do të bëja fillimisht kur ta gjeja. Dera e dhomës së tij ishte e pambyllur, kështu që nxitova brenda pa trokitur, duke e gjetur në shtrat me Enën, një kritike muzike që po na shoqëronte kohët e fundit në të gjitha turnetë. Pa thënë asnjë fjalë, e kapa nga kyçi i këmbës dhe e tërhoqa nga shtrati duke e flakur në dysheme.

“Je çmendur? Idiot, - bërtiti Ena. - Lëre! Çfarë do më shumë nga ne?” Ajo më goditi në fytyrë dhe duar, por unë e kapa Ivanin nga qafa, duke e gjunjëzuar atë galiç. Ai as u mbrojti fare. Ishte flegmatik, gjë që më zemëroi edhe më shumë. Dukej sikur e dinte se gjithçka do të mbaronte keq për mua dhe se përfundimisht plani i tij do të realizohej siç duhej. Ndërsa i shtrëngova qafën, fytyra verdhacuke me mjekër po i fryhej dhe sytë po i buzëqeshnin keqas, sikur donte të thoshte: “I gjori”. “Pse e bëre këtë? Përse?” - i bërtita, ndërsa Ena më goditi me karrige në shpinë, pas së cilës u shemba në dysheme pranë Ivanit. Ai rrinte ende i shtrirë aty, duke më parë me ata sytë e tij të përlotur. Gjëja e fundit që më mbeti në kujtesë ishte buzëqeshja e tij përbuzëse.

Ky imazh m'u rikthye fill pas zgjimit të parë në Institut. E kuptova edhe se pas shumë kohësh pata polucione nate dhe se mëngjesi filloi me një dhimbje koke torturuese dhe

kutërbimin që buronte nga muret e çara të dhomës së madhe të akullit në të cilën po qëndronim ne të dhjetë pacientët. Rrija shtrirë mbi një dyshek ushtrie të hollë dhe ia kisha ngulur sytë tavanit që i ngjante hartës së një deti të panjohur. Me kalimin e kohës, lagështia kishte gdhendur atje thellësitë e ndryshme të rrënojave të kësaj bote spitalore. “Një ditë do të na bjerë mu në kokë,” - dëgjova zërin e dikujt pranë meje. Kur u ktheva, pashë atë plakun e mbrëmshëm, i cili, duke ngritur jastëkun në kornizën metalike të shtratit, u fiksua në një pozicion gjysmë të ulur dhe nisi të lexonte. Flokët gri i ishin shpupuritur, kurse ashtu të dendur të kujtonin një kaçubë të pazbutur. “Çfarë është...?” - e pyeta. “Tavani, - foli shkurt burri dhe, pa më parë fare, shtoi: - A nuk e shikon vallë tavanin?” “Po”, - iu përgjigja. Fytyra e gjatë dhe e parruar më kujtoi një Maks von Sydov¹ të moshuar, kurse sytë e tij të mbuluar nga vetulla gri dukeshin si dy varëse lëkure që po i binin nga balli i rrudhosur.

“Unë jam Julius, - u prezantua, duke më zgjatur dorën, - doktori Markus Julius.” Ne shtrënguam duart midis shtretërve. “Doktor?” - u habita. “Po, isha, - u përgjigj me ironi, - në atë jetë... Ne të gjithë kemi qenë diçka në një jetë të shkuar, apo jo?” Pastaj vazhdoi leximin. Në kopertinën e librit të tij të vjetërsuar dallova titullin në italisht. Ishte *La Divina Comedia* e Dantes. “E njoh pakëz letërsinë italiane”, - i thashë duke rënkuar nga dhimbja në tëmtha dhe u mbulova

¹ Max von Sydow (1929-2020) ishte aktor i njohur suedezo-francez me një karrierë që shtrihej mbi 70 vjet në kinemanë, televizionin dhe teatrin evropian dhe amerikan.

deri në mjekër me batanijen që kutërbonte. Për një çast, kjo lloj strehe nga drita më kënaqi, por shpejt gumëzhima në kafkë u rikthye. Doktor Juliusi nuk tha asgjë. Dëgjova frymëmarrjen e tij të çrregullt dhe herë pas here poteren e dikujt nga ana tjetër e dhomës. “Ku përfundova?” - i thashë vetes, duke zënë hundën. Bota përreth meje kish ndryshuar kaq shpejt, ndërsa u rrëzova tashmë në kanalet e saj drejt një shpelle të errët në fund të së cilës gjendej ai pavijon me pacientët që prisnin të përfundonin rehabilitimin, ndërkohë që imja ende s’kishte filluar. Të paktën kështu më tha dr. Soldatoviqi nga AUS-ja. “Patologjia jote s’mund të trajtohet më në një spital të zakonshëm, - konstatoi, - por vetëm në institucione të specializuara, të cilat janë të dedikuara për këto raste.” Por këtu nuk po shihja asgjë të veçantë, përveç lagështisë, të ftohtit dhe erës së keqe. Nga larg dëgjohej një derdhje uji dhe gurgullima e lehtë që vinte nga tubat. Po prisja një vizitë për të kërkuar ilaçe kundër dhimbjeve, por nuk erdhi askush. Ne thjesht qëndronim aty dhe po prisnim.



Në dhomën e vogël të ngrënies, të sajuar në zgjatimin e korridorit që të drejtonte nëpër pavijonin tonë, aroma e ushqimit përzihej me erën shpuese të amoniakut, ardhur nga tualeti aty pranë. Pjatat mbi tavolinat e vogla gri ishin të yndyrëzuara në mënyrë të tillë që ishte e vështirë të pastroheshin ndonjëherë si duhet, ndërsa këmbët metalike të mobilies së vetme qenë shtrembëruar. Në banakun e hapur shfaqej herë pas here fytyra e mbushur e një kameriereje që pacientët e thërrisnin Bosa. Sipër saj ishte bashkangjitur

një televizion me një kanal të vetëm - DMSAT¹, i cili transmetonte vazhdimisht videoklipe muzikore folklorike të viteve 1990. Në reklama kalonin mesazhet e vjetra të njerëzve nga rajoni dhe diaspora, entuziastë për *Elefantin Blu*. Dr. Juliusi, me bujari, më bëri shenjë drejt një vendi bosh në tavolinën e tij, jo shumë larg nga dritarja me hekura prej së cilës shquheshin pemët dhe ndërtesa fqinje. Përpara saj, pacientët u rreshtuan sikur po përgatiteshin për një marshim të detyruar, por nuk mbanin asgjë të veçantë për të veshur, përveç një rrobe të gjatë me vija, lidhur me litarë. Ndonjëri mbante veshur ndonjë xhakëtë të vjetër mbi pizhame dhe një kapelë me zgjatime për veshët. Duke ma kapur shikimin pyetës, dr. Juliusi më shpjegoi se do të bënin një shëtitje të zakonshme rreth oborrit të spitalit dhe që edhe ne së shpejti do të ndiqnim gjurmët e tyre. “Ata nuk janë ushqyer për ditë të tëra, - tha pas një pauze të gjatë, duke e zhytur fetën e tij të zezë në sherbet. - Kjo është arsyeja, ndër të tjera, pse u rebeluan.” Në fillim iu tha se transporti i bukës kishte pasur një ndalesë për shkak të një stuhie dëbore, por kur ajo zgjati, vendosën të dilnin jashtë dhe të kërkonin vetë diçka në qytet. Mali Gjurit, mikut të tij, i kishte rënë dy herë të fikët ndërkohë nga uria, kur e morën atë vendim. “Dhe pastaj gjithçka doli jashtë kontrollit”, - më shpjegoi dr. Juliusi, edhe pse nuk e pyeta për asgjë. Ishin shtatë prej tyre që rrinin tashmë para portës dhe u ndanë në dy grupe ndërluftuese. Ai, sigurisht, mbështeste një shkuarje të qetë deri te dyqani më i afërt i ushqimeve,

¹ “DM Sat” ka qenë një kanal me videomuzikë, kabllor-satelitor, nga Pozharevac i Serbisë.

ndërsa grupi i dytë drejtohej nga pacienti Topisireviq. Në të njëjtën kohë, Juliusi më tregoi me vështrim burrin qimekuq, mbushur me tatuazhe që ia mbulonin krejt parakrahët, qafën dhe deri fytyrën. Ai rrinte ulur në një grup me dy pacientë të tjerë kokërruar që po e dëgjonin me vëmendje se çfarë po u thoshte ai nën mustaqet dhe mjekrën e rrallë. “Topi”, - siç e quante Juliusi, ishte i vendosur për një veprim shumë më serioz, pasi dëshironte të futej me forcë në stacionin e policisë, të merrte armë dhe të negocionte me autoritetet në lidhje me bukën fillimisht dhe pastaj lirimin e tij nga Instituti. Juliusi besonte se shtigjet e çlirimit do të duhej të çonin në drejtim tjetër, kështu që u përpoq ta bindte nga kjo ide, e cila shpejt u shndërrua në një grindje: në fund u vendos që të gjithë të bënin atë që e mendonin se ishte më e drejta. “Vetëm Beatriçe, - tha Juliusi dhe u ndal, duke fshehur fytyrën me duart kockëmëdha, - vetëm ajo nuk po e dinte se nga cila anë do të përfshihej.” Kur e pyeta se kush ishte kjo Beatriçe, m’u përgjigj se “ishte vajza nga Siria, Asja, që u nis me ta”. Kishte qëndruar në Institut për plot dy vjet, por në një pavijon tjetër të përzier, ku u soll nga një qendër private për emigrantët pranë Suboticës. Ajo ishte e shpërqendruar sepse mbeti pa të shoqin, i cili arriti ta kalonte ilegalisht kufirin hungarez. Mbeti duke e pritur, por s’u kthye më kurrë tek ajo. Kur Juliusi e njohu në Institut, ajo tashmë kish nisur ta kuptonte gjuhën tonë, kështu që filloi të kalonte gjithnjë e më shumë kohë me të, duke i dhënë mësimë gjuhe, në mënyrë që në këmbim të dëgjonte historitë e saj për Rakën, ku gruaja e re arriti të shpëtonte me të shoqin përpara pushtimit të islamikëve. Ndërsa po ma tregonte, mua po më fanepsej vazhdimisht para syve

fytyra e mbytur në brigjet e Danubit, por nuk i thashë asgjë, tashmë thjesht vazhdova ta dëgjoja dhe të tundja kokën. Doktor Juliusi u koll dhe u kthye nga Topi dhe grupi i tij sikur përgjigjja të qëndronte pikërisht aty. Me vështirësi ngriti vetullën e majtë, prej së cilës poshtë shkëlqeu syri i gjelbër i çelët. “Beatriçes iu desh të zgjidhte”, - tha, midis tij dhe Topit, njerëz që korrespondonin me dy pjesë të ndryshme të personalitetit të saj dhe me të cilët ndante jetën e përditshme në Institut, ku pjesa e parë mbushej sërish nga Juliusi. Në fakt, ajo shpesh i tregonte se sa shumë ngjante Topi me të shoqin, i cili ishte i madh dhe i çrregullt, me atë mjekrën e rrallë që asaj i pëlqente t’ia ledhatonte. Ai kishte natyrë të dhunshme dhe nuk kishte frikë nga asgjë. Mezi e bindi të largohej nga Raka dhe të nisej me valën e refugjatëve nga Siria. Dhe kur ata e ndërmorën më në fund atë hap, ai iu betua se nuk do të ndalej derisa të gjenin vendin e tyre nën diell, diku në Evropë. Ndërkohë, këtu u përballën me një mur, të cilin ai arriti ta kapërcente, ndërsa ajo qëndroi për ta pritur, duke bredhur e vetme në një botë të panjohur. Ishte vetëm njëzetë e tre vjeçe. Kurse i shoqi ishte të paktën pesëmbëdhjetë vjet më i madh se ajo. Pikërisht aq sa dhe Topi. Ndoshta në atë moment, përpara portës, mendoi se duhet të ndjekë atë ndjenjë të brendshme të përputhshmërisë midis atyre të dyve, e ku ta dish ndoshta diçka tjetër e tërhoqi drejt tij. “Rruga që ne zgjedhim, - shtoi Juliusi, - shumë shpesh arrin të na surprizojë.” Për të, ajo ishte Beatrice, kurse për Topin, ajo ishte gruaja e vogël siriane, të cilën e haste çdo mbrëmje në ndërtesën e vjetër të ekonomisë bujqësore. Gjatë verës së kaluar, Juliusi ndonjëherë i afrohej tinëz dhe i pëlqente që, si një fantazmë,

të vëzhgonte mbi dridhtimin e trupave të tyre. Më në fund ishte udhërrëfyese i saj, i cili konsiderohej përgjegjës për gjithçka që ajo përjetoi në Institut dhe, për rrjedhojë edhe për vdekjen tragjike. Kur gjërat mbrëmjen e pardjeshme shkuan keq, Juliusi ishte i bindur, se ajo nisi ta kërkonte atë mbi Danubin e ngrirë, derisa aq e dërrmuar nga të ftohtët dhe vuajtja, u dorëzua dhe nuk arriti t'ia dilte mbi akull. Ajo duhet ta ketë kuptuar atëherë se Topi nuk mund ta ndihmonte, por ishte vonë, sepse grupet e tyre ishin ndarë në drejtime të ndryshme.

Juliusi, me shokët e tij, Mali Gjuri dhe një burrë që e quante Kujtim, u nisën në kërkim të ndonjë dyqani ushqimesh. Ata ishin të uritur dhe duhej ta gjenin ushqimin sa më shpejt të qe e mundur. Kështu bënë derisa në një rrugë të errët të Kovinit, duke ecur me vështirësi nëpër dëborë, u hasën me dritaren e vogël të një dyqani me ndriçim të zbehtë. “A mund të jetë kjo?” - pyeti Kujtimi dhe, para se të dëgjonte përgjigjen, mësyu me të gjithë fuqinë përmes dritares. Alarmi nuk ra, askush nuk u shfaq në këtë natë që binte borë, derisa shoku i foli nga rrënojat: “E po, eh, ky na qenka dyqan materialesh ndërtimi me vida dhe, dreqin, qenka dhe për gozhda!” Kjo është arsyeja pse vazhduan më tej, duke bastisur edhe dy vitrina të tjera gjatë rrugës, disa dyqane bojërash dhe dyqane të vogla pajisjesh. Për fat të mirë, Mali Gjuri gjeti pará në një sirtar në dyqanin e bojërave, që kuptohet se i morën dhe u sulën pas Juliusit, i cili pretendonte se kujtonte një vend ku do të hanin mirë: ishte restoranti “Utva”. Kur i tërhoqën vëmendjen për faktin se restoranti ishte fiks përballë stacionit të policisë,

ai thjesht tundi dorën dhe tha se duhet të hynin me qetësi në klub dhe të porosisnin darkë, pa shumë bujë, mu sikur të ishin turistë të zakonshëm që ndaluan rastësisht në Kovin. Kështu edhe bënë në fakt. Megjithatë, në restorant gjërat nuk shkuan aq mirë. Që kur hodhën vështtrimin e parë përreth i bënë klientët të fillonin të largoheshin nga restoranti derisa mbetën vetëm ata të tre. Kamerieri nuk iu afrua edhe kur Juliusi me edukatën dhe në mënyrën e tij të sjelljes i drejtua: *signore, prego*, dhe i kërkoi t’u shërbente. Ai u tha nga vendi ku rrinte se do të telefononte policinë nëse nuk largoheshin menjëherë dhe ta lëshonin objektin, prandaj Mali Gjuri dhe Kujtimi iu hodhën përsipër menjëherë dhe pastaj e lidhën kamerierin në një karrige. *Miserabile uomo* u përpoq, i rrahu këmbët në dysHEME, karrigia u rrëzua, por shpejt u lodh dhe vazhdoi të shikonte shfaqjen përpara tij. Dhe, kështu kaloi. Më para, Gjuri shkoi në kuzhinë dhe i kërkoi kuzhinierit të frikësuar t’u sillte atyre gjithçka që kishte në dispozicion. Dhe, me të vërtetë, kishte gjithçka aty: nga mezeja e vendit shërbyer mbi një pjatëz dërrase, te kumbullat e thata mbështjellë me proshutë, pashteta pate me krem djathi dhe, lloje të ndryshme sallatash, gjellë me mish gjahu, varietete të ndryshme mishi të pjekur në skarë, perkelt¹ me mish viçi, qengj me qumësht dhe rozmarinë,

¹ (Gastronomi) Perkelt, i shkruar edhe si “pörkölt” në hungarisht, është një gjellë tradicionale hungareze me mish, që shpesh konsiderohet si pjatë kombëtare. Është pjatë e shijshme dhe gatuhet ngadalë. Përmban mish (viçi, derri, qengji ose pule), qepë dhe piper të kuq, me një salcë të pasur dhe të shijshme. Ndryshe nga gulash, perkelt zakonisht ka një salcë më të trashë dhe më pak perime.

deri te krempita¹, shnenokli² dhe bakllavaja me arra dhe lulëkuqe. Dhe sa për verërat, kishte qoftë të bardhat apo dhe të kuqet, veçanërisht nga ato llojet që diplomatëve tanë u shërbehen në pjatat zyrtare për Ditën Kombëtare dhe, sak nga ato të cilat pronarët e kafeneve me përvojë mbajnë zakonisht në fund të bodrumit për t'ua servirur mysafirë të veçantë, siç ishin pacientët e Institutit atë natë. “Në të vërtetë, - më tha Juliusi, ndërsa lotët po i rridhnin nga palosjet e rrudhave që i fshihnin sytë, - diçka filloi atje për të gjithë ne”, për fat të keq dhe për Beatricën e tij, e cila po e kërkonte në stuhinë e dëborës ndërsa ai me miqtë e tij po zdërhalleshin në përfitimet e befta të një jete të mjerueshme civile. Atë çast mbërriti një treshe daullexhinjsh në “Utva”, të cilët duket se ishin punësuar për të luajtur aty në çdo mbrëmje, po kur e panë kamerierin të lidhur dhe ata të tre me tavolinat e bashkuara, mbi të cilat ndodhej një grumbull ushqimesh dhe peshqirë të pistë, ata u përpoqën të iknin, por ishte tepër vonë. Si për ta, ashtu dhe për Beatricën, që atë moment po përleshej me lumin. Gjuri nuk po i kushtonte shumë vëmendje muzikës, por vazhdoi të hante sikur të ishte vakti i fundit i jetës, ndërsa daullexhinjtë e hutuar filluan ta luanin me urdhër të Juliusit një këngë nga

¹ (Gas.) Krempita, e njohur edhe si fetë vaniljeje ose fetë kremi, është një ëmbëlsirë me shtresa e njohur në Evropën Qendrore dhe në Ballkan. Përbëhet nga një bazë brumi sfoliatë dhe një mbushje kremoze dhe e ëmbël me krem vaniljeje. Ëmbëlsira njihet për kontrastin e saj të këndshëm midis brumit krokant dhe kremit të butë e të pasur.

² (Gas.) Lloj keku me qumësht.

kohërat e dikurshme, në të cilat kërkohej e pamundura, *për të ndaluar Danubin*, sepse edhe ai, njësoj si ai këngëtari nga Baçka, *dëshironte të kujtonte gjithçka*.



Pavijoni numër dy. Reparti i rehabilitimit. I dedikuar për meshkujt. Numëroheshin gjithsej tridhjetë e shtatë pacientë, dymbëdhjetë prej të cilëve tashmë e kishin marrë një kurë trajtimi dhe rehabilitimi; gjashtëmbëdhjetë ishin në gjendje të mirë shëndetësore, ndërsa nëntë syresh merrnin trajtim të veçantë te mjekja Larisa Sibinoviç, e cila erdhi me atë rast nga Universiteti i Leidenit me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes. Të gjithë pacientët ishin të lindur midis viteve 1970 dhe 1979, përveç doktor Juliusit, i cili ishte i moshuar dhe askush nuk e pyeti kurrë për vitin e lindjes ose që kur kishte nisur punë këtu. Dihej vetëm se gjendej prej kohësh në Institut dhe se ngurronte të fliste për këtë histori, dhe se para kësaj kish punuar si psikiatër në Akademinë Mjekësore Ushtarake në Beograd. Kisha lexuar diku se në fund disa mjekë përfundojnë me pacientët e tyre, por doktor Juliusi nuk ishte një rast i tillë, të paktën nuk dukej kështu. Ai ishte ndryshe nga të gjithë të tjerët, sidomos nga mjekët që herë pas here parakalonin nëpër korridore, të shoqëruar nga disa persona me rroba civile, për të cilët thuhet se ishin të ministrisë, të cilët mbikëqyrnin programin special që po zbatohej. Sidoqoftë, askush nuk ia kishte idenë se për çfarë bënte fjalë programi dhe madje as Juliusi vetë nuk fliste për të. Ai më shumë i besonte Dantes dhe veprës së tij poetike,

realizuar nga fillimi i shekullit të katërmëdhjetë, siç i pëlqente të thoshte, sesa atyre *farabutëve*¹ që erdhën me teoritë e inokulacionit² të stresit në përpjekje për ta zhdukur nga pacientët e tyre, duke i mësuar kështu ta njohin dhe t'i përgjigjeshin programit në kohën e duhur: në fakt, për ta harruar. Ata mendonin se stresi është si bacili, i cili, sapo të hyjë në trup, duhet të hasë në antitrupa të gatshëm që të arrijnë e ta izolojnë shpejt, dhe kështu t'ia zvogëlojnë edhe virulencën. Juliusi, në të kundërt, mendonte se imazhi i traumave tona ishte shumë më kompleks dhe duhej kërkuar në vizionet e parajsës dhe tokës, të cilat u parashtruan nga Dante në veprën e tij *La Divina Comedia*. Por kjo ishte një ide shumë e rrezikshme, sepse kjo do të nënkuptonte se pacientit duhet t'i mësohej ngjashmëria e vërtetë e një shoqërie, e cila shkaktonte atë traumë tek ai. “Kur arrin ta përjetosh traumën, - më tha Juliusi ndërsa bora krisej nën këmbët tona gjatë xhiros në kompleksin e madh spitalor, - kupton se ajo është produkt i aktiviteteve shoqërore, edhe sikur të ishin fjala vetëm për ndarje dashnorësh. Natyrisht, kjo nuk e pakëson dhimbjen e shkaktuar nga ai akt, por veç dëshiron të thotë se lufta, vdekja dhe krimi nuk janë të vetmet shkaqe të stresit. Ka edhe nga ato ngjarje të vogla që na dëmtojnë për gjithë jetën. Dhe ne s'mund më të dimë t'i rikthehemi, por vazhdimisht kërkojmë një rrugëdalje te një imazh që na kthehet vazhdimisht në kujtesë. Ky në të

¹ (Kroatisht) Grabitësve.

² (Mjekësi) “Inokulimi” i referohet futjes së një agjenti, siç janë mikroorganizmat ose një substancë që përmban mikrobe sëmundjesh, në një organizëm të gjallë.

vërtetë nuk të çon askund, thjesht na mban në gjendjen e një vigjilence të përrjetshme, sikur të jemi me një rojë të vdekur, ndërkohë që trupi na vuan, nervat nisin të dorëzohen, na vjen gjumë, vuajmë nga migrena ose pagjumësia dhe mjafton edhe një gjest i vogël për të na ngjallur zemërim dhe agresion. Kur ndihemi të këputur, - më mësoi doktor Juliusi, - atëherë jemi edhe të dhunshëm. Dhe çfarë është më e keqja, jemi gati të lëndojmë shumë ata që janë më të dobët sesa ne.”

Në momente të tilla kemi nevojë për një udhërrëfyes, - tha më në fund doktor Juliusi kur një infermier na urdhëroi të rreshtoheshim në dy rreshta dhe të përballeshim me përditshimin e diellit, i cili më në fund po dilte pas shumë ditësh mbushur me re. Tani ajo skenë po më përndjek, më dukej joreale, ashtu si historia e Juliusit për thyerjet te ne, të cilat i kisha mbajtur për vite me radhë të ndrydhura, por kurrë nuk arrita t'i shikoj në mënyrën se si m'i paraqiti ai. Trajtimi me anën e rrezeve të diellit ishte një kontribut i veçantë prej doktoreshës Larisa Sibinoviç, të cilin ajo donte ta praktikonte sa herë të ishte e mundur në Kovin. Ajo e konsideron shumë këtë terapi, - më pëshpëriti doktor Juliusi pas shpine, - pasi sipas saj rrezet e diellit mund të na ndihmojnë të rrisim transformimin e vitaminës D në kalcium, pa të cilin sekretimi i endorfinës, hormoneve të lumturisë, është i pamundur. Kështu ishim dhe ne nga Departamenti i Rehabilitimit, që të ekspozuar ndaj diellit dimëror, prisnim dozën tonë të përditshme të lumturisë, të cilën nuk arritëm ta ndienim kurrë, pasi për ne ishte kaq larg, e që për një moment shkëlqimi mashtroes na largoi nga hapësira e gjerë e spitalit.

Ndërsa po e kundroja diellin në distancë, pothuajse i mbuluar nga retë që i fshinin kufijtë realistë të peizazhit, m'u kujtua koha që kalova në Lviv, sepse ajo natë e sherrit tim me Ivanin nuk do të ishte e fundit në atë qytet. Kisha fjetur pjesën tjetër të natës dhe pothuajse nuk u çova fare gjatë gjithë të nesërmes. Gjatë asaj kohe, askush nuk më hyri në dhomën e hotelit dhe madje as nuk më thirri në telefon. Vetëm rrezja e fundit e diellit në perëndim, që iu lëshua dritares dhe shpërtheu në pasqyrën ngjitur me krevatin më bënë shenjë se kishte kaluar koha dhe se duhej të ngrihesha. Edhe pse koka vazhdonte të më dhembte, shkova në banjë dhe bëra një dush me ujë të ftohtë në shtëpi. Kontrollova telefonin dhe kuptova që Mathiasi më kishte dërguar tashmë një duzinë mesazhesh, e të gjitha me përmbajtje të njëjtë: “Çfarë drejtin po ndodh atje?” Iu përgjigja se gjithçka ishte në rregull, edhe pse e dija që asgjë nuk ishte siç duhej dhe se do të më duhej ende të debatoja me saksofonistin që, me sa duket, vendosi të na e shkatërrojë Kuartetin-F dhe të krijonte bendin e vet të quajtur “Shën Gjon” ose diçka të tillë. Në një moment, kuptova se dhimbja e kokës më ishte qetësuar, sepse aksionin e mori tashmë një cimbisje në shpinë, ndërsa duke e këqyrur më mirë veten në pasqyrë vura re edhe disa mavijosje nga goditja e Enës me karrige. *E bukur*, mendova, filluam të ndaheshim nga të gjitha lidhjet. Dola nga “Eurohoteli” dhe shkova në sheshin “Rinok”, ku duhej të takoja Grujiqin dhe Nikun, kitaristët tanë. Ndërkohë, në një kafene të vogël nën muret e kështjellës, Ena po më priste në një tavolinë. Ajo mbante syze të reja dielli dhe ishte ulur me këmbët e kryqëzuara, sikur po pozonte për ndonjë kopertinë apo një reviste mode. Ndala

për një moment, por kur ajo më shikoi nga poshtë syzeve si për të pyetur: “Po tani, a do t’ia mbathësh”, iu afrova dhe u ula në karrige pa thënë as edhe një fjalë. “Një pije, - sugjeroi ajo dhe shtoi: - për pajtim...” “Nëse është prej teje, atëherë një dopio *jameson*”, - iu përgjigja dhe u fsheha pas syzeve të diellit. Ena porositi një pije dhe vazhdoi të luante me një këllëf argjendi *Gucci*. “Ku është ai?” - e pyeta. “Nga ta di, po trajtohet... Gati e mbyte...” “Oh, dreqin, - thashë duke pranuar gotën e uiskit si shpëtim, - ai vërtet e dhjeu. Mos duhet që tani t’i ndreq unë të gjitha këto...” “Nuk ke pse, - tha papritur Ena pajtuese, - le t’i rishqyrtojë ai veprimet e tij, e ti të tuat.” “E mendova se ishe në anën e tij”, - u përpoqa të tregohesha ironik, të paktën kështu m’u duk mbrëmë. Ajo buzëqeshi dhe gjerbi një gllënjë: “Unë jam në anën time, zemër. Dhe, dëgjo, ky qytet është *absolutely fabulous*, e kam studiuar pak... Mund ta vizitojmë edhe së bashku... Si thua?” Duke ndjekur Enën në Lviv, u përpoqa të kujtoja se si na u shfaq në jetën tonë. Më erdhën disa tinguj nga një koncert i KKN në *Gun Club*. Unë dhe Ivani mbërritëm mjaft vonë dhe kapëm një vend të lirë në banak. Po interpretohej pjesa e vjetër *Glow I Light*, për të cilën kisha dashur të punoja prej kohësh dhe ta përfshija në repertorin e Kuartetit-F. Ivan as nuk do të donte ta dëgjonte, sepse nuk besonte se do të kishte mbetur ndonjë gjë nga ajo këngë që ia vliente për të bërë një aranzhim të duhur xhazi. *That fight for light’s the one that I will always remember*. “Për këtë është *catch*, - i thashë, - duhet të lësh vetëm disa vargje dhe të ndryshosh melodinë bazë. Zhvendos theksin nga *rule forever* në *everyday fight*, - i shkela syrin, - xhazi fillon diku këtu. *Never attacked by such a heavy offender*.”

“E po, - u shkund Ivani, duke porositur një pije, - gjithçka është e kotë... Shiko se çfarë po bën Haxhimanovi?” “Dëgjo, nuk më intereson asnjë lloj muzike etnike, vëlla, - qortova veten, ajo përmbante Yuga¹ dhe disa tradita të tjera. *For a while I thought that I was gonna surrender.* - Nuk më the nëse të ka ofruar ndonjë vend në bandë?” - e pyeta. “Kush, - me sa duket u hutua, - Haxhimanovi? Çfarë të ra kështu në mendje...”

Pas koncertit na u afrua një zeshkane shtatlartë nën shoqërinë e bateristit Vlade nga KKN. E kisha njohur më herët, kur në klubin “Dolar” luajta me disa rebelë *post-punk*, të cilët më vonë iu përkushtuan një biznesi më serioz. Vetëm ai mbeti ende në këtë zanat. Na prezantoi me të njohurën e vet, kritiken muzikore Ena, e cila prej kohësh dëshironte të na bënte një intervistë, por nuk kish mundur dot, derisa në fund ia doli të publikojë vetëm një intervistë me Ivanin, i cili iu ankua deri në fund për kushtet e punës në Beograd dhe në mënyrë indirekte për statusin e vet në Kuartetin-F. Kur i thashë pas kësaj se nuk më pëlqeu mënyra se si fliste për grupin, ai thjesht bëri atë grimasën e padurueshme, duke më thënë se kurrë nuk do të kuptoja se çfarë është marketingu. Pikërisht, sak atëherë u mëdysha për herë të parë se duhej t’ia flakëroja një shuplakë, por u përmbajta dhe thashë se, nuk ishte puna ime, ai mund të shkonte menjëherë te Haxhimanovi dhe t’ia linte vendin në kuartet dikujt tjetër, ndoshta Enës, që mburrej se kishte marrë dikur mësimë në piano. “Ah, Ena, - buzëqeshi Ivani, - ajo është një artiste në shumë instrumente...” Nuk ia kisha idenë se

¹ Në Rigveda, *yuga* u referohet brezave, një periudhë kohore (qoftë e gjatë apo e shkurtër) ose një zgjedhe (bashkimi i dy gjërave).

çfarë donte të thoshte, por atë mbrëmje në Lviv, ndërsa po e ndiqja nga dyqani i të brendshmeve, e kuptova mirë se aktrimi ishte forca e saj e pamohueshme. Ajo donte të blinte me çdolloj çmimi një palë sytjena në “*Victoria’s Secret*”, sepse e kuptonte se në Beograd nuk do të mbërrinin kurrë modele të tilla. Prandaj qëndrova me durim para kabinës me perde, vetëm që ajo të më shfaqej me sytjena dhe brekë, joshëse dhe e lëmuar, siç na shfaqej shpesh në mbrëmje pas performancave tona. Dendur dëshironte të ulej midis Ivanit dhe meje, duke më cukur shpesh me të gjithë gjatësinë e saj të kofshës. “Pra, si të duken?” - më qeshi nga kabina. “Mendoj se Ivani do ta pëlqejë”, - i thashë ndërsa po i mbaja perden. Ajo hyri atëherë brenda në shenjë proteste, e tërbuar tërhoqi perden dhe vazhdoi të ndërrohej. Duke u mbështetur lehtë në kornizën e derës, i thashë se kisha lexuar diku, para se të niseshim për këtë turne, se në Lviv, gjatë Luftës së Dytë Botërore, hebrenjtë e vetëm që mbijetuan ishin fshehur në kanalizime. Pyesja veten sesi ata njerëz që e përjetuan atë luftë aq keq, për të mos thënë tmerrshëm, nëse do të kishin qenë pjesë e njësive të pushtimit dhe të qeveritarëve kuislingë, si do të mundeshin të vazhdonin të jetonin kur të kishte mbaruar gjithçka. Pastaj perdja u hap papritmas, duke ma zbuluar Enën, e cila qëndronte në shpinë dhe e përkulur pak përpara, me një korse të zezë dhe me doreza që i arrinin deri në bërryla. Ndoshta thjesht keni gruan e duhur pranë vetes, buzëqeshi në mënyrë flirtuese. Ajo më kujtoi *Mater Morbin* e errët dhe joshës, llojin e imagjinuar nga ilustruesi italian Massimo Carnevale¹, si nëna e mëkatit, epshit dhe

¹ Massimo Carnevale (Romë, 1967) është karikaturist dhe ilustrues italian.

të gjitha sëmundjeve tona. Në atë moment kuptova që atë mbrëmje në Gun, bashkë me sëmundjen time ende të padiagnostikuar, ajo tashmë më kishte në duart e saj.



Një çift ndihmësmjekësh, të cilët pacientët i thërrisnin Hekler dhe Koh, erdhën tek unë herët në mëngjes, para se të arrija të mësohesha me bardhësinë që depërtonte përmes dritareve të larta me hekura direkt e në dhomën tonë të gjumit, si e vetmja dozë e rehatisë së përditshme. E pashë i hutuar Juliusin, por meqë ai vazhdonte të ishte ende në gjumë, veshat ngathtësisht pantoflat dhe rrobën dhe e lashë veten të udhëhiqem prej tyre. Më drejtuan nëpër oborr, meqë ra fjala, dhe më në fund më futën në dhomën e daktreshë Sibinoviqit, e cila po shikonte e vrenjtur ekranin e kompjuterit. Më ulën në një karrige masive metalike, më lidhën duart me prangat që ishin aty, më ngjeshën kaskën deri në nivelin e syve dhe më pas ulën vizorin pak të errësuar. Nëpërmjet saj vura re siluetën e mjekes, dhe e vetmja gjë të cilën mund ta dalloja me plot ngjyra ishte shkëlqimi i syzeve përballë një ekрани kompjuteri. Këtë herë dallova vargje shkronjash dhe numrash, pastaj diagramin në formën e kutive të ndryshme me ngjyra. Ndërsa ajo po rrëshqiste poshtë faqes, gjithçka u shndërrua në një kaos faktesh që dukshëm e shndërruan atë në humor të keq.

Zëri i saj tingëlloi i ftohtë kur më pyeti se si po ndihesha në këtë ambient të ri. Pas një pauze të shkurtër, iu përgjigja se po përshtatesha ngadalë, porse më shqetësonte fakti se nuk e dija se ku gjendej instrumenti im, pasi asnjëherë nuk

isha ndarë prej tij. Ishte si një pjesë e zgjatur e trupit tim, e cila, pa dyshim, tashmë nuk mund të përdorej më prej meje. Si ndonjë bisht, i cili ka humbur funksionin e tij dhe është atrofizuar, por ende mund ta ndiej diku në fundin e shtyllës kurrizore. Ky vëzhgim personal dukej se i interesoi, prandaj ngriti sytë nga ekrani për një moment dhe më tha se kontrabasi im gjendej në një vend të sigurt të një magazine me kyç dhe që mund ta merrja vetëm në momentin kur do të arrija të luaja. Absolutisht jo përpara kësaj. E jo për arsye thjesht shqetësimi për kujtimet materiale apo emocionale, çfarë mund të ishin shndërruar për mua ndërkohë.

“Kjo është jeta ndryshe e një instrumenti”, - iu përgjigja, duke e pyetur nëse ajo kishte mësuar ndonjëherë të luante në ndonjë instrument. Kur më tha se kishte pasur një flaut kur ishte fëmijë, por nuk kishte ndjekur kurrë shkollë muzike, kuptova se nuk mund të flisja seriozisht me të për artin muzikor. Nuk e di se çfarë kuptoi ajo me atë rast, sepse këmbënguli në atë temë në vazhdimin e bisedës. E gjitha çka ishte e interesuar, lidhej me kontrabasin tim: kur fillova ta mësoj për herën e parë, ku e studiova xhazin, me cilin profesor, kur dola për herë të parë në publik, ku tamam dhe me kë? Si u ndjeva atëherë? A kam pasur bllokime të ngjashme në të kaluarën dhe si filloi gjithçka?

Unë me të vërtetë nuk e kujtoja se kur nisa të luaj, ndoshta në moshën gjashtëvjeçare, kur kumbari im më solli një kitarë të vogël akustike si dhuratë, pa dyshim një lodër, të cilën e përqafova si gjënë time më të çmuar nga jeta. Pas ca kohësh, babai më regjistroi në një shkollë muzikore dhe kështu filloi e gjitha. Mësuesja ime e kitarës,

Olga Petronijeviq, në Çuprija, ku jetoja në atë kohë, nuk lodhej shumë, ajo thjesht e kishte zakon të hynte në klasën e vogël, ulej me trupin e saj të stërmadh mbi karrige, fuste një karamele mente në gojë dhe, fill më urdhëronte të luaja. Vështirësi i saj tretej në distancë, ndërsa në fakt atëherë as denjonte të më shikonte me sy, por e gjitha konvertohej në kapjen me vesh. Vetëm ajo faqja e saj e fryrë, e mbushur me karamelen, pulsonte herë pas here teksa kapte ndonjë gabim timin, rrëshqitje nga ritmi, duke më bërë të numëroja mbrapsht me veten para çdo lëshimi të telit, deri në tre dhe kështu bëhej çdoherë nga fillimi, derisa kompozimi nuk do të arrinte të luhej në mënyrë perfekte. Në fund ngrihej fluturimthi sikur kishte bërë ndonjë ecje të mirë dhe më thoshte se një muzikant i mirë nuk lind, por bëhet dhe, jo duke i thyer telat, por duke u praktikuar me dëgjimin. Pastaj ngrihej me mundin e saj, shkonte te dritarja, e hapte dhe më rishfaqte botën e oborrit të shkollës. “Ja, - do të më thoshte, - përpiku të më tregosh se çfarë tingujsh dëgjon jashtë tani.” Dhe unë nisja të mendoja se si ta dalloja klithmën e një fëmije nga goditja e topit të basketbollit në fushë, lojtarët që bërtasin pas tingujve të bilbilit, zhurmën e makinës që është e parkuar nga zëri i shitësit të farave përpara një shkollë ose bukurinë e përplasjes së krahut të ndonjë zogu. “Mos mendo se si ta bësh atë, - më paralajmëronte mësuesja Olga, - përpiku të ndjesh dhe t’i dallosh valët e zërit.”

“Mirë, - tundi kokën doktoresha Sibinoviç, - ndoshta mund t’i konsiderojmë dhe ne valët e mësueses Petronijeviq.” Më pas më shpjegoi se kishte një bazë të madhe të dhënash në kompjuter, me tinguj të regjistruar, që do të më luheshin

në mënyrë alternative gjatë kohës që më monitoronte reagimet. Më takonte vetëm të thosha asociacionin e parë me tingullin që do të dëgjoja. Veçse shpejt, pa u menduar, ashtu siç ma kërkonte mësuesja e kitarës. Nuk arrita t'i them asgjë dhe tashmë vala e parë e zërit erdhi përmes kufjeve vendosur në kaskë. Dëgjova rrotullimin e një rrote druri mbi kalldrëm. “E kaluar”, i thashë. Pasi një shkullm ere. “Dritare”, shtova. Erdhi kërcitja e një karrigeje në dysHEME. “Shkollë”, përsiata. “Po, gulçima e motorit... babai”, përfundova unë. “Pse babai?”, pyeti doktoresha Sibinoviç. “Sepse makina shpesh nuk mund të ndizej me të parën.” “Le të vazhdojmë”, shtoi ajo. Dëgjova zhurmën e frenimit. “Gushti”, thashë. Erdhi fragmenti nga pjesa *I Remember When* e Getz-it¹ që më bëri të ndaloja një moment dhe të thosha: *Stockwerk Cafe*. Thyerja e xhamit - Mobilizim. Çukitja e qukapikut në pemë - Koha. Gulçima - Kuverta. Tingulli i kasës - Pink Floyd. Grisja e hartës - Hrabal. Trokëllima e trenit - Beograd. Stuhia - Jugosllavinë. Valët e detit - Humbja. Valët e detit - jua thashë një herë: Humbja! Klithmat e pulëbardhave - Asjan. “Cila Asja?”, më pyeti doktoresha. “Fatkeqja Asja, - konfirmova, - Asja Alasaf.” Doktoresha përsëriti klithmat e pulëbardhave, ndërsa unë u përpoqa të liroja duart që të mos e hiqja kaskën dhe u vërsula të shoh mes syzeve të saj. “Pse Asja?”, këmbënguli ajo. “Ju lutem, ndërpriteni! - bërtita. - Ajo ishte në një gjendje tjetër.”

¹ Stan Getz (1927-1991) ishte një saksofonist amerikan i xhazit. Duke luajtur kryesisht saksofon tenor, Getz njihej si “Tingulli” për shkak të tonit të tij të ngrohtë dhe lirik, ku ndikimi i tij kryesor ishte timbri i hollë dhe i butë i idhullit të tij, Lester Young.

“Nga e dini se ajo ishte në një gjendje tjetër?” “Kështu m’u duk, kur e pashë...” “Oh, e patë në breg?” “Po, kur arrita në Kovin... Fikeni atë tingull, po ju lutem!” Megjithatë vazhdoi, ndërsa unë u përpoqa pa sukses, të liroja duart. Në halucionacionin tim pashë diagramet në syzet e mjekes, ku vlerat e kuqe u rritën, për këtë shkak ajo buzëqeshi sikur të kishte marrë një mesazh nga i dashuri. “Jemi këtu”, tha ajo dhe e mbylli programin.

Gjithçka kaloi në heshtje, por në veshët e mi mbeti krokita e vazhdueshme e shpendëve të detit. Ishte e padurueshme. Këmbët m’u drodhën sikur të kisha marrë ndonjë goditje elektrike. “Keni partnere apo partner?”, më pyeti doktoresha Sibinoviç pasi u qetësova. Iu përgjigja se kisha, por nuk isha më i sigurt për këtë. “A është më në Beograd?” “Jo, nuk e besoj, mendoj se u largua... Nuk e di më se ku është.” Ajo qeshi dhe shtoi se, falë teknologjisë moderne, disa njerëz qëndrojnë me ne përgjithmonë. Mund t’i telefonoja nga kompjuteri i saj, ndoshta edhe të vendosja lidhje me *Skype*. Iu përgjigja se nuk doja asnjë lloj kontakti dhe se është shumë më e lehtë për mua ta kaloj në këtë lloj mënyre. Mjekja u habit nga shprehja “më e lehtë”. “Më e lehtë në çfarë lloj kuptimi? Mos nuk mendoni më për të apo ajo gjendet aq larg sa ju nuk e ndieni fare aurën e saj energjike?” Ajo vetë ka një burrë dhe dy fëmijë në Leiden dhe është në kontakt të vazhdueshëm me ta, ndryshe nuk do ta kishte duruar këtë institucion, mbuluar me borë dhe akull. Dhe aty gjendet edhe mentori i saj, profesor Heeg, pa të cilin do të kishte humbur. Mund ta provoja edhe unë. Ajo mund të më siguronte komunikim pesëmbëdhjetë minuta në javë për këtë qëllim. Sigurisht, me kusht që të m’i regjistronte të gjitha bisedat.

Sibinoviqi ma tha këtë paraprakisht, sepse gjithçka që realizohej në praktikën e saj duhej të dokumentohej, përfshirë edhe analizat përfundimtare të rastit tim. Dhe jo vetëm rasti im. Po kështu, personi në anën tjetër nuk duhet të paralajmërohet se po regjistrohet dhe se ekspertët tanë kanë akses në biseda. Sigurisht, bëhej kryekëput për qëllime shkencore. Nëse do të pranoja një marrëveshje të tillë, ajo duhet të më ofronte një formular për ta nënshkruar. Përndryshe, mbetem jashtë kontaktit me botën e jashtme, madje edhe me jetën time të mëparshme. Do të ishte një lloj terapie familjare, e cila mund të ishte e dobishme për të gjithë, veçanërisht për mua.

Iu përgjigja se mund ta firmosja, por kjo nuk garantonte se do të mund të vendosja ndonjë kontakt.

“Sigurisht, - thashë, - që nuk ishte e drejtë me bashkëbiseduesit e mi, sepse do të duhej që edhe tjetri ta dinte se gjithçka po regjistrohej.”

Doktoresha Sibinoviqi vetëm sa e tundi kokën dhe, duke u ngritur nga tavolina, erdhi për të më marrë kaskën. Që terapia të kishte sukses, ishte e nevojshme që rrjedha e bisedës të ishte sa më e natyrshme, përndryshe asgjë nuk do t’ia vlente. Pastaj më zgjidhi dorën e djathtë, e ngriti dhe, duke ma kthyer pëllëmbën lart, dëgjoi pulsën tim. Gishtat e saj ishin të ftohtë, ashtu si dhoma e vizitës dhe si i gjithë institucioni i rrënuar që nuk ngrohej dot me asgjë, sepse nga muret e plasaritura dhe punimet me dru të kalbur, i ftohti depërtonte brenda çdo skute të saj.

“Do të ishte gabim i madh nëse nuk do të luanit më kurrë”, - tha befas, sikur e kuptoi pasi më numëroi rrahjet e pulsit. Pastaj ma lëshoi edhe dorën tjetër, kurse unë i

thashë se e kisha humbur tashmë kontaktin e brendshëm me muzikën dhe se nuk ndieja më fare asgjë.

“Do t’i fillojmë pilulat në mëngjes,” - shtoi, duke u kthyer në tryezë.

Pastaj nxori dy formularë bosh nga sirtari dhe i shtyu nëpër tavolinë drejt meje. Njëri ishte për filmimin e bisedës dhe tjetri, siç shtoi ajo, meqë ra fjala, do të kishte lidhje me pëlqimin tim për t’iu nënshtruar trajtimit me antidepressantë të rinj nga një kompani farmaceutike nga Holanda, cilësinë e të cilëve e garantonte vetë ajo. As që e vura re se gjatë të gjithë asaj kohe Hekleri dhe Koh po prisnin të qetë pranë derës. Pasi firmosa, ata u afruan, më kapën poshtë sqetullave dhe më shoqëruan jashtë në ftohtësinë e vërtetë. U çapita duke u lëkundur, tërhiqesha zvarrë përgjatë shtegut në dëborë, duke i lënë ata të më mbanin herë pas here të mos rrëzohesha, ndaj të dy, herë pas here, më afroheshin për të më kapur që të mos këpitesha. Ndihesha si një dordolec i mbushur me lecka, që tani e vërvitin ngado sipas dëshirës. Dr. Sibinoviqi po tërhiqte telat, ndërsa Hekleri dhe Koh ishin thjesht e vetëm rekuizionistë që po nxirrnin gjëra të panevojshme nga fondi i Institutit për t’i flakur më pas.



Dëgjova gurgullimën e ujit në tuba, kur në një moment të natës doktor Juliusi u fut në konvikt. Dera u mbyll shpejt pas tij dhe përsëri mbretëroi errësira, në të cilën vetëm silueta e doktorit zhvendosej përgjatë një rruge të mësuar symbyllazi prej kohësh. E dëgjova pastaj se si u kollit

ndërsa u lëshua dhe ra mbi shtrat. Susta kërciti, por asgjë nuk arrinte t'i zgjonte pacientët e tjerë. “Doktor”, e thirra qetësisht dhe qëndrova në pritje me kokën e ngritur nga jastëku. Ai vetëm sa po merrte frymë ngjirur, duke kërkuar një vend më të mirë për t'u mbështetur. Meqenëse sytë e mi u mësuan me errësirën, i shqova figurën në një pozicion gjysmë ulur, në të cilin ai zakonisht kalonte ditët e pleqërisë në këtë Institut. “Bisedat e zakonshme”, u përgjigj pas pak kohe nga errësira, kur mblodhi mjaftueshëm forcë. “Apo në mënyrë rutinore”, do të thoshte dikush. Të tilla dëgjoi shpesh në jetë dhe jo vetëm i njohu, por do të ishte tashmë pjesëmarrës në mjedise të ndryshme policie, qelie, dhoma, bodrume, zyra, biruca, ku merreshin në pyetje persona që kuptohet se nuk vinin sipas dëshirës. Ai vetë ishte një i tillë syresh. Më tha me qëllim “ishte, sepse nuk ishte më kështu, të paktën jo si dikur në verën e vitit 1995, kur, diku nga mesi i korrikut, i erdhi radha ta merrnin mu në mes të natës. Ata po i binin ziles dhe trokitën me radhë, sikur do t'i vinin flakën qiellit dhe tokës. Schnauzeri¹ i tij bojëkaf, Papa Çelestino, ia behu drejt derës, pa pushuar së lehuri. Iu desh t'i lidhte një zinxhir më të shkurtër para se t'ua hapte dhe t'i linte brenda. Ishin dy veta, të veshur me kostum, të paktën njëzet vjet më të rinj, i gjati me xhaketën që kishte parë në stafin që sorollatej nëpër departamentin e AUS-së ku punonte. Një nga ata të dy u afrua te llamba e ndezur e bibliotekës sipër kolltukut, mbi të cilin deri vonë ishte ulur dhe lexonte *De Revolutionibus orbium coelestium* të Kopernikut. Në fakt,

¹ Schnauzer-ët janë një racë qensh me origjinë nga Gjermania, të njohur për fytyrën e tyre dalluese me mjekër dhe mustaqe.

vetëm një literaturë e tillë e ndihmoi për plot dhjetë ditë me radhë të ruante shëndetin prej pushtimit të *stupid*a me legjitimitetin e shërbimit të sigurimit apo partisë. Pastaj oficeri i policisë i hodhi një sy librave dhe më pas e pyeti nëse i kishte lexuar vërtet të gjithë këta. Juliusi vetëm sa tundi kokën, për çka polici i tha se ishte mirë që i kishte nxënë, sepse morën urdhër ta drejtonin në një vend, ku atij do t'i duhej e gjitha ç'kishte lexuar dhe veçanërisht të jepte shpjegime për librat e pakuptueshëm, siç ishte edhe ai mbi kolltuk. "Si është ky vend?" - pyeti. "Do ta shohësh shpejt", qeshi polici dhe e urdhëroi të përgatiste gjërat më të mundshme.

"Toponime të caktuara përmes emrave e fshehin disi thelbin e tyre", - më pëshpëriti dr. Juliusi prej errësire. Kjo ishte e njohur për një kohë të gjatë, por ai s'kishte dëgjuar kurrë më parë për atë Majë të Zezë të veçantë, sepse në jetë kishte parë shumë maja të zeza, ashtu si dhe në hartat topografike, të cilat i përdorte dikur në rininë e tij. Megjithatë, kjo ishte një e vetme, bash Maja e Zezë e tij, që ndodhej diku në lindje të Serbisë, ku do ta shoqëronin atë natë. Edhe pse i luti për ta marrë Papën me vete, ata nuk e lejuan, kështu që pa dëshirë, e la në banesë, me disa enë me ujë dhe ushqim, pasi nuk e dinin t'i thoshin se sa kohë do t'i duhej të qëndronte ende në atë vend. Kur mbylli derën pas vetes, Papa filloi të lehë si kurrë më parë. I dhembte stomaku nga trishtimi, ndaj u përpoq të ngrihej në sediljen e pasme të xhipit që e lidhte nga rruga "Çingrija", ku jetonte drejt udhëve që as e dinte se kishin ekzistuar ndonjëherë. Pas disa orësh vozitjesh, ata arritën në një rrugë të ngushtë të asfaltuar së fundmi, e cila përshkonte përmes një pylli

qindravjeçar ah. Vendi quhej Dubashnica, siç i thanë pasi dolën papritur në një pikë vrojtimi, ku ndaluan në mënyrë që të urinonte. Juliusi tashmë kishte probleme me prostatën, dhe kur ishte i mërzhitur duhej të shkonte në tualet shumë më shpesh se zakonisht. E kujtonte mirë atë natë, se doli në një errësirë të zezë zift mbi një kodër në mesin e një pylli që e pushtonte atë vend nga të gjitha anët, por nuk arriti kurrë ta rrokte me pamje deri në fund. U orvat shumë ta nxirrte penisin e flashkur dhe, kur u lëshua rrjedha e parë në errësirë, mermëriti duke ngritur sytë në lartësi: gati sa nuk u mbyt nga pamja e kupës qiellore aq afër tij, sa e ndjeu kokën një moment se po gjendej mes yjeve. Mund t'i dallonte qartë yjësitë e Arushës së Vogël dhe Arushën e Madhe, Kasiopean dhe yjësinë e verës së Lirës. Ai mendoi si për Kopernikun, ashtu dhe vendin ku po e përcillnin, për të cilin tashmë e kishte një ide se çfarë po e priste. Ndërsa po shurronte lart në terrenet e gjuetisë në Dubashnicë, Juliusi kuptoi se ekziston një konflikt midis mekanikës qiellore të lëvizjes së përhershme të një trupi në hapësirë dhe atij vendi të fshehur në pyll. Para se të vazhdonin udhëtimin, i vunë një thes të rëndë në kokë dhe vetëm atëherë u nisën për më tej. Nuk udhëtuan shumë, kohë kur xhipi ndaloi. Një nga ndjekësve i tha: “Këtu jemi!” E kapën nga krahu dhe e nxorën jashtë. Ai dëgjoi kodin që shtypej në interfon dhe pastaj hapjen e derës. E çuan në një hapësirë ku ndjeu erën e drurit dhe duhanit. Ata u ngjitën me një ashensor të ngushtë dhe pa ajër. Pasi e nxorën, ia hoqën thesin dhe i treguan me gisht derën luksoze të një apartamenti. “Presidenti po të pret”, - i tha njëri nga dy policët. Ai tundi kokën, sepse gjithçka iu bë e qartë nga shumë kohë më parë, thjesht u nis me ata brenda.

Juliusi hyri me kujdes në sallonin gjysmë të errët, i cili ishte pjesërisht i ndriçuar nga drita e ekranit të televizorit, ku shquheshin dy pantera që po zbaviteshin me një antilopë të kapur. Kafsha e plagosur gjendej e shtrirë mbi barin e rrallë të savanës dhe po rezistonte në zgrip të fuqive duke luftuar me këmbët e pasme. Pastaj një pjesë e hijes pranë raftit u shkëput nga tjetra dhe ndërhyri në dritën gri të ekranit. Dr. Juliusi ngriu nga frika kur ngadalë filloi të shquajë në atë hije të animuar figurën e presidentit, këmisha e zbërthyer e të cilit dilte nga fundi i tutave. Për momentin nuk mundi ta lidhte atë foto me atë që shihte rëndom në televizion. Ia kapi dorën, e shtrëngoi në mënyrë të sikletshme dhe i tha: “Po ku jeni, o doktor. Ia bëfsha t’ëmën... Po ju presim gjithë ditën e ditës.” Juliusit gati sa nuk iu shqit krahu nga shtrëngimi i tij, kështu që, në pamundësi për të parë para vetes, e hodhi vështrimin në brendësi sikur po kërkonte një vend për të vendosur torbën. Mbizotëronin mermeri dhe lëkura, mobilie masive me një tapiceri të trashë, parehati, së cilës i ishin ngjitur doreza të mëdha pa shije. Dallohej telefoni me aparat faksi mbi tryezën e stërmadhe. Një njoftim për serialin *Srećni Ljudi*¹ vinte nga televizori. Jashtë është koha e ujkut, dëgjohej zëri që këndonte i Boba Stefanoviqit, dhe ai, Juliusi, e dinte shumë mirë që nuk ishte më jashtë, por prapëseprapë ishte i vetëm dhe thellë në atë natë, qendra e së cilës ndodhej në atë vilë rezidenciale. “Çfarë ju ka ndodhur, - e pyeti, - përse më keni sjellë këtu?”

“Po jo, unë vetë jam mirë, por ime shoqe, si të thuash, ka një problem”, - iu përgjigj presidenti duke i zgjatur një

¹ "Njerëz të lumtur" (serbisht)

gotë uiski. “Faleminderit, nuk pi, - iu përgjigj Juliusi. - Për çfarë është fjala?” “E po, ja edhe unë për këtë do të doja ta dija, doktor. Ndonjë djall po... Si t’ju them, diçka nuk shkon me të... Ajo ka një skuqje të lëkurës dhe është mbyllur në dhomë duke qarë, ja ku është, e shtrirë...” “E po, ky është specialisti i dikujt tjetër...”, - u mbrojt Juliusi. “Jo, jo, tashmë kanë qenë disa specialistë, siç thatë ju, por të gjithë thonë se është për një psikiatër, kështu që u ktheva te ministrja Leposava dhe, ajo më rekomandoi pa mëdyshje emrin tuaj.” Juliusi vetëm sa ngriti supet dhe kërkoi ta shihte pacienten.

“Në krevatin masiv të dyfishtë në dhomën e gjumit me imitim të një baldakini me saten të kuq, - më tha doktor Juliusi në mënyrë konfidenciale, sikur të frikësohej mos po përgjonte kush, - qëndronte e shtrirë përmbys gruaja e presidentit, vetëm se ishte e mbuluar me një cohë të madhe transparente nën të cilën mund t’i dallohej trupi kaba.” Ishte me fytyrën e rrasur poshtë një jastëku të madh, në atë mënyrë që Juliusi të mund të shihte vetëm një tufëz të flokut të saj të zi që notonte mbi satenin e bardhë. Presidenti i bëri shenjë me gisht nga karrigia pranë shtratit dhe më pas i tha së shoqes se doktori më në fund kishte ardhur. “Shyqyr që nuk më latë të vdes”, - tha ajo me zë të lartë nga jastëku. “Si jeni... zonja Markoviq?”, - foli disi doktor Juliusi, duke mos ditur si t’i drejtohej. “Uh-uhh..., - bërtiti dhe mezi arriti të kthejë kokën drejt tij: nga flokët e dendur u shfaq fillimisht hunda e saj e lakuar, e cila njësoj si pjesa tjetër e trupit ishte e mbuluar me njolla të kuqe, të cilat i ngjanin gjurmëve të ndonjë krijese me këmbë të deformuara. - Unë po vdes, doktor, - i tha më në fund, - gjithçka më kruhet

dhe më dhemb dhe, më fryhet, e digjet dhe, përsëri më mundon pamasë ndërkohë që askush nuk e kupton ç'kam, po çmendem me këtë gjendje.”

“A ju kanë dhënë ndonjë antihistaminik?” - e pyeti Juliusi duke përveshur mëngët e këmishës. “Unë jam dendur me antihistaminik, doktor, - iu ankua ajo ndërsa u drodh e tmerruar, - më ndihmoni pak... - dhe sërisht u kthye. - Më dërrmoi të gjallë...” “Ndoshta keni ngrënë diçka të pazakontë, kërpudha apo boronica, apo mish të ndonjë kafshe të egër?” - u interesua Juliusi, duke vënë re një kokë të madhe dreri të balsamosur në murin përballë. Kafsha kishte brirë të mëdhenj dhe po ia vështronte me vëmendje të pasmet e kolme Markoviqkës, që ngriheshin e binin nën ritmin e frymëmarrjes së saj të dobët. “Nuk kam futur asgjë në gojë, doktor. Prej dy ditësh të tëra...”, - iu ankua. “Mos vallë keni dëgjuar ndonjë lajm tronditës?” “Po çfarë lajmi i keq, erdha të festoj përvjetorin e partisë sime... Unë u thashë miqve se do të bëja një banket që s’e keni parë kurrë ndonjëherë, porositëm ushqime dhe pije, bodrumi ishte plot, por kuzhinierët as nuk patën kohë të përgatisnin gjë, kur tak më ndodhi kjo habi.”

Juliusi nxori një xham të madh zmadhues nga çanta dhe u përkul mbi pacienten. “Do të më falni, - i tha ai, - por do të më duhet ta heq rrobën.” Pastaj, me një lëvizje të kujdesshme, evitoi fërkimin mes garzës dhe lëkurës së irrituar, ia grisi gruas së presidentit, e cila tashmë qëndronte krejtësisht e zhveshur. “Juh-juh”, - u ngërdhesh ajo. Syri me përvojë i Juliusit ndoqi lupën që tregonte gunga alergjike përgjatë trupit të saj: pore të zmadhuara, lëkurën e saj të djersitur, nishanet e zeza me qime të fryra, tufa me njolla,

rrudha të lagura, plagë dhe gjurmë të një qepjeje të vjetër me fije kirurgjikale. “A është e mundur vallë, - pyeti Juliusi, - që atij t’i shërbejë tani kjo grua, e cila së bashku me të shoqin vendosnin për gjithçka në këtë vend, edhe jashtë tij, dhe tani e kishte në duar?” Ndërkohë kutërbimi i trupit e paralajmëroi se nuk ishte kështu, sepse, edhe në atë pozicion, gjendej nën pushtetin e saj, si dhe nën sundimin e të shoqit, i cili po rrinte ulur në dhomën e ndenjjes, duke parë *Srećne ljudi*, gjerbte uiski dhe qeshte me budallallëqet e një çifti tjetër të martuar, i cili kishte vite që argëtonte masat me shfaqjen.

“Duket se ke të drejtë, - i tha doktor Juliusi në fund të ekzaminimit, - mund të vdesësh nga kjo.” “Mos, doktor, si nuk e pa njeri këtë më parë...”, - u ankua znj. Markoviq, duke vënë të gjitha forcat të kthehej anash. Për një moment, ajo i kujtoi Juliusit një kopje të një pikturë të Rubensit. “Unë të them, që mundeni, por nëse do të vendosim çfarë të solli këtu, ndoshta nuk ka pse të ndodhë e keqja”, - shtoi ai më ngushëllues. E më pas, duke e mbuluar sërish me garzë, i shpjegoi se si funksionon sistemi imunologjik te vertebrorët me nofulla. Bëhet fjalë për një sistem mbrojtës kundër patogjenëve dhe, ka të ngjarë se nuk duhet të jetë rreptësisht patogjen, anipse të disa njerëz mund të çojë edhe në reagime psikosomatike, siç ka shumë të ngjarë të kishte ndodhur në këtë rast tek ajo vetë. Fjala është për një lloj nënvlerësimi psikik, dhe i tha: “Nuk e dinte si t’ia shpjegonte ndryshe mekanizmat kompleksë, nënvlerësimin e kujtesës së saj imune. Pacienti, për shembull, i bindur se kishte shytat, shkon për të vizituar dikë që e kishte atë sëmundje dhe pak kohë më pas sëmuret tamam nga e njëjta sëmundje.

“Po kështu, në mënyrë plastike, - shpjegoi doktor Juliusi, - është e mundur që ju ta keni kryqëzuar veten në diçka që keni bërë, dëgjuar ose parë, në të cilën besonit se s’mund t’ju dëmtojë. Është edhe më dramatike nëse i kuptuat këto të gjitha, por ende nuk doni t’ia pranoni as vetes suaj. Shumë kohë më parë, përpara zhvillimit të psikiatrisë, një prift, zhvilloi një sistem rrëfimi midis besimtarëve të vet, i cili, si një nga shtatë sakramentet, solli ekuilibër të mëkatit të kryer me faljen e tij. Mohimi i mëkatit mund t’i çojë besimtarët individualë deri në pikën e kujtimit. Në jetën bashkëkohore, rrethanat janë të ndryshme, por problemi mbetet fare identik. Alergjitë nganjëherë aktivizohen si pasojë e mohimit të imunitetit ose realitetit social, kështu që banketi i planifikuar, le të themi, mund të merret si një shkak i mundshëm...”

“Po çfarë po më thua!” - e qortoi ashpër Markoviçka, duke ia rrëmbyer Juliusit xhamin zmadhues nga dora dhe e përplasi fort për muri. Thjerrëza ra dhe u rrotullua mbi shtrat. Pastaj nisi të bërtasë dhe i thirri të shoqit, i cili fillimisht u ngatërrua në dhomën tjetër për t’u shfaqur së shpejti në derë, gati i frikësuar: “Çfarë, si është puna?” “Ma largo këtë budalla nga shtëpia! Menjëherë!” - e urdhëroi dhe e zhyti përsëri kokën në jastëkun e madh. Juliusi arriti të kapte çantën para se policët ta tërhiqnin zvarrë jashtë, duke ia rikthyer thesin e mëparshëm mbi kokë. Kur e lëshuan, ishte shumë herët në mëngjes dhe, ai e kapi veten se ndodhej në stacionin e autobusëve të Borit. Rrinte i ulur në një stol dhe sodiste harabelat që po kërcenin në pluhur, jo shumë larg kioskës me prodhime të furrës. Ai e dinte se këtë e tutje nuk do të ishte më i lirë si ata zogjtë. Mendoi vetëm për

Papën dhe nxittoi të merrte një biletë për autobusin e parë që të çonte në Beograd.



U ulëm në një dhomë të madhe pa ngrohje, e cila dikur ndoshta kish shërbyer si sallë kinemaje, ndërkohë që ishte e rrënuar, prandaj përdorej fare rrallë. Kishte një dysHEME druri të ngrënë nga krimbi me dy vrima të mëdha në mes. Inspektori Bozhoviq, i cili ecte me nervozizëm sa majtas-djathtas, i duhej t'i kapërcente sa herë që arrinte para ndonjërës syresh. Ai mbante të veshur një xhaketë me pupla dhe një kapele të thurur, ndërsa ne rrinim të ulur me pizhamet dhe rrobën e spitalit. Meqenëse nuk kishte vende të mjaftueshme për t'u ulur, disa nga pacientët sollën me vete edhe stolat nga dhoma e ngrënies. Pas shpinës së inspektorit varej një kanavacë e madhe në të cilën projektohej imazhi. Ne ndoqëm me vëmendje pikën e kuqe të laserit me të cilin shënonte pikat, ku pacientët rebelë të Institutit lanë gjurmët, siç tha ai, të veprimeve të tyre kriminale. Ndërsa po na e tregonte këtë, dukej i qetë, por toni po i bëhej gjithnjë e më i lartë me përparimin e prezantimit.

“Rebelimi i Kovinit, - theksoi inspektori Bozhoviq, - pati dy drejtime veprimi qysh në fillim: i pari shkoi drejt objektit të “Utvas” dhe i dyti drejt Danubit.” Ai i përcaktoi pacientët Julius dhe Topisireviq si nxitësit dhe drejtuesit kryesorë, por tha se pas një ndalese të shkurtër, asnjë nga shtatë protestuesit e arratisur nuk u shfajësua për atë

fakt. Policia në Kovin, e ndihmuar nga anëtarët e MUP-it¹, Shërbimit për Luftën kundër Krimit të Organizuar ndaj Republikës, ia arriti të rindërtojë të gjithë ngjarjen, t'i burgosë dhe t'i kthente pacientët e arratisur në Institut, ashtu si dhe për të përgatitur një raport për ngjarjen fatale, i cili tashmë ndodhej mbi tavolinën e drejtorit të policisë. Në të njëjtën kohë, inspektori rrëshqiti vazhdimisht pikën e kuqe në hartën e Kovinit, ku një grup prej tyre arriti të grabiste disa dyqane të ndërmarrjeve private për të hyrë përfundimisht në lokalin “Utva”, ku u keqtrajtuan qytetarë, u rrah kamerieri dhe iu shkaktuan dëme të mëdha materiale pronarëve të objektit. Ndaj tyre është ngritur një kallëzim penal, ndërsa grupi tjetër, me të cilin mbeti e plagosur tragjikisht pacientja A. A., ka kryer veprën penale të sulmit ndaj njerëzve të shërbimit në kryerjen e detyrave të tyre. Çështja ishte për një sulm ndaj shefit të policisë të Kovinit, rreshterit Dejan Ristiq, të cilit me atë rast iu konfiskua arma, pistoleta e tipit CZ99² me municion. Sulmi është kryer në parkingun e hotel “Stari Grad”, ku po bënte shërbimin rreshteri. Me atë rast u çarmatos dhe u zhvesh lakuriq. Rreshteri u keqtrajtua nga ana e Topisireviqit dhe të tjerëve që e shoqëronin në këtë veprimtari kriminale kundër Kushtetutës së Republikës së Serbisë. Sipas dëshmisë së të plagosurit, rreshterit Ristiq, i cili tani gjendet në Qendrën

¹ Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Serbisë (serbisht: *Ministarstvo unutrašnjih poslova*, romanizuar: *Ministarstvo unutrašnjih poslova*) shkurt: MUP.

² Zastava CZ99 është një pistoletë gjysmë automatike e prodhuar nga “Zastava”. U zhvillua në vitin 1989 për të zëvendësuar M57 në ushtrinë dhe policinë jugosllave.

Klinike në Beograd, është urdhëruar që viktima, ashtu pa rroba e këpucë, të ecë mbi dëborë deri në Danub, ku më pas vijoi çapitja në akull, mbi të cilin Topisireviqi, sipas rreshterit, qëllloi disa herë me armën e shërbimit të grabitur me qëllimin për të hapur një vrimë nga e cila rreshteri do të binte brenda në lumë. Kërcënimi për jetën dhe sigurinë publike kulmoi me vdekjen e pacientes A. A., e cila vdiq nën rrethana gjithmonë shumë të pashpjegueshme. Asnjë gjurmë torture ose lëndimi nuk iu zbulua kufomës. Ajo u gjet të nesërmen në mëngjes në një degë të lumit, mu në fillim të Kovinit të Danubit. Hetimi për vdekjen e saj do të vazhdonte ende. Megjithatë, inspektori Bozhoviq kërkoi përgjigje në pyetjen se ku ishte fshehur arma e vjedhur nga rreshteri Risti, si dhe nëse ndonjë nga oficerët e punësuar në Institut mori pjesë në organizimin e kësaj trazire. Policia bëri intervista informative me të gjithë, por nuk gjeti përgjigjet e duhura për asnjë nga dy çështje kyçe. Meqë nuk erdhëm në këto përgjigje, përfundoi inspektori, duke u hedhur mbi vrimën, mbetet një rrezik i përhershëm i një incidenti të ri, i cili do të mund të përfundojë edhe më tragjikisht. Prandaj regjimi policor në Institut do të vazhdojë të jetë në fuqi deri në një njoftim të dytë. “Gjithashtu, - shtoi, - policia do të vazhdojë ta bëjë punën individualisht, ndërsa këta do ta bëjnë diskutime informative në grup në formë periodike, me kërkesën e daktreshës Sibinovi me qëllimin e demokratizimit të procesit të hetimeve.”

Sapo e mbaroi prezantimin zhurma e pacientëve u rrit. Një hije mosbesimi dhe frike përshkoi fytyrat e dobësuar dhe të errësuar. Në thellësi të sallës dallova edhe paciente femra nga pavijoni fqinj, të cilat i ngritën me kujdes stolat e

tyre dhe po prisnin të përfshiheshin me kolonën që po dilte ngadalë nga salla. Ndërkohë një polic me uniformë kaloi mes turmës, iu afrua Topisireviqit dhe i dha një shenjë me kokë ta linte stolin e vet duke u nisur me të drejt daljes. Shpejt, pasi ata u zhdukën nga fushëpamja ime, dr. Juliusi m'u afrua, duke mbajtur stolin në gjoks, me këmbët e kthyer përballë meje, sikur të ishte pjesë e ndonjë formacioni ushtarak mesjetar. “Çfarë të thashë? - qeshi ironikisht dhe bëri disa lëvizje me vetullat, pas së cilës ato u zhytën edhe më thellë në kafkë: - *Stupidi!* Gjithmonë e njëjta pyetje e gabuar. Ku dhe kush? Dhe asnjëri prej tyre ende nuk ka pyetur *pse* dhe *si*.”

Në fund të fundit, këtë u përpoq t'i shpjegonte asaj nate gruas së presidentit, por edhe ajo nuk e njihte pyetjen më të rëndësishme në një varg të tillë: *Perché?* Kur në fund të asaj vere i sollën për të vizituar një ushtar nga Brigada e Bratunacit me ankth çrregullimi fobik, Juliusi gradualisht filloi të zbulonte fragmente të tmerrshme të asaj që ndodhi vërtet në Potoçari. Realisht, shkalla e vërtetë e asaj që po përpiquej t'i shpjegonte pacientit të vet obez ishte shumë më e madhe se çdo gjë që mund të hamendësonte. Banketi i saj i planifikuar, që gjithsesi u mbajt, pasi ata i hodhën përfundimisht plot antihistamine dhe kortikosteroide, ishte si një lloj *danza macabra* në Majën e Zezë. Dhe ai vetë kërceu vallen e hapjes me atë zonjën me kocka të gjera të legenit dhe nofullat e forta dhe, ai vallëzim u zhvillua mbi varret e të pafajshmëve që, në të njëjtën kohë, me urdhër të burrit dhe të asaj vetë, sapo ishin zhvendosur në gropat e sapohapura atypari.



Doktoresha Sibinoviç më la në kompjuterin e saj, ku pak më parë çela llogarinë time në *Skype*. Rendita në anën e majtë adresat me të cilat isha në kontakt më parë, por më pas fshiva gjithçka dhe lashë vetëm një: atë të Darias. Doktoresha më këqyri dhe pohoi me kokë. E la llambën e tavolinës pranë një globi të madh në të cilin sipërfaqet ujore ishin të ngjyrosura me një blu të lehtë. Edhe pse e dija që çdo moment do të regjistrohej, prita derisa ajo të dilte nga dhoma e më në fund klikova në butonin jeshil të ikonës së dëgjimit. Makineria u ndez, ndërsa kodi i përbërë nga vargje njësishe dhe zerosh filloi të rrotullohej në hapësirën kibernetike mes meje dhe Darias që kushedi se ku ndodhej atë çast. Dhe, pas shumë përpjekjesh, kur po mendoja të hiqja dorë, tingulli pushoi dhe në ekran u përvijua një imazh i turbullt, i cili u kthjellua me kalimin e kohës, duke më zbuluar një dritare me pamje nga ndërtesat fqinje të banimit.

Xhami i dritares po vibronte sikur do të copëtohej nga momenti në moment. Grila u ul në një të tretën e lartësisë së dritares, duke zbuluar rreshta ballkonesh identike në fasadën e gjelbër të çelët të ndërtesës, të cilat, ndërsa struktura zgjerohej, u zbehën në nuanca gjithnjë e më të errëta, nga gri-jeshile në të zezë. Në kryqëzimin e ndërtesave shquheshin gjurmët e ujërave të shiut, të cilat tani ishin të maskuara nga akujt e mëdhenj. Bora po lëvizte. Nga oborri përcillej potencia e fëmijëve të shkollës. Dikush në anën tjetër më pas lëvizi kamerën, kuadri u ul dhe unë mund të dalloja çatinë e ndërtesave shkollore, pemët e zhveshura dhe makina të

parkuara me sipëroret e mbuluara me të bardhë. Teksa një kamion po përshkonte rrugën ngjitur me shkollën, një degë e thyer e ndau një shirit nga masa e bardhë e borës mbi sipëroret dhe e copëtoi në miliona kristale që refuzonin të pajtoheshin për një kohë të gjatë me forcën e gravitetit.

Një baner vertikal me mbishkrimin “Adria Sigurimi” qëndronte në buzë të një ndërtese me fasadë tullash. Ishte e lidhur me litar, i cili të jepte përshtypjen e një si qepje të madhe, bërë me makinë. Era gjeti edhe mbi të një fije të grisur, ndaj kur vendosi të fryjë me të gjithë fuqinë, e ka nxjerrë litarin, në mënyrë që reklama në një moment të shëmbëllente me xhepin pjesërisht të grisur të një këmishe.

E ndjeva praninë e Darias në kokrrizën e ngjizur të pikselit, që ndërmjetësoi imazhin në anën tjetër të ekranit. Pothuajse po ia ndieja edhe kundërmimin. Edhe pse fyti m’u shtrëngua, dëshiroja të paktën t’ia shihja dorën në botën e kufizuar që lejonte imazhi i *Skype*, ndoshta duke u afruar nëpër tavolinë, teksa merrte një filxhan çaji ose duke përdredhur me nervozizëm ndonjë fije floku. Por asgjë nga këto nuk mund të kapej, përveç pjesës tjetër të ditëve që ishin vendosur atje si një dunë rëre.

“E di që je aty”, - mezi munda të them. Ndërkohë dritarja mbeti e palëvizshme, grila vazhdonte të vibronte, teksa dritat e para po ndizeshin pas dritareve të pallateve aty pranë. Një llambë rruge e hodhi dritën lart. Në atë tufë në formë hinke, bora po rrotullohej, duke më zbuluar shqetësimin e thellë të të gjithë hapësirës, e cila dukej sikur po pluskonte në heshtje. Papritur ra zilja e shkollës, fëmijët bërtitën, gumëzhima e makinave u mbyt nga stuhia e dëborës, prej së cilës shpërhapeshin erërat monotone, mu krejt si vibrafoni

në fillim të kompozimit “*Bejrut*” të xhazistit libanez nga Bejruti Ibrahim Maalouf¹, trumbeta e të cilit më pas do të shpërthente në plan të parë, duke shpejtuar butësisht vorbullën nga peizazhi dimëror, i cili pushtoi gjithë botën me një lëvizje të padukshme para syve të mi.

“Kaq, mjafton për sot”, - tha doktoresha Sibinoviç duke hyrë në dhomë nga jashtë pa trokitur. Instinktivisht e mbylla lidhjen, por mbeta i ulur para ekranit, duke u përpjekur të shpëtoja copëzat e fotove që po shikoja pak më parë.



Vizitat në Institutin e Rehabilitimit ishin të ndaluara, ashtu si edhe thirrjet telefonike ose çdo mjet tjetër komunikimi, *Skype* ose *Viber*, përveç nëse parashikoheshin për qëllime terapeutike, gjëra të cilave mjekët si dr. Sibinoviç i ndiqnin vetë rast pas rasti. Biseda me botën e jashtme ishte e rrezikshme, duke pasur parasysh gjendjen e pacientit që i nënshtrohej terapisë, të cilit mund t’i cenohej ekuilibri, duke supozuar se një gjë e tillë mund të arrihet brenda mureve të atij kompleksi spitalor. Sa i përket orarit tim në *Skype*, doktoresha më paralajmëroi kur po dilja se nuk duhet ta dinte askush përveç ne të dyve. Kjo ishte e lidhur direkt me qëllimin e shërimit tim. Deri në takimin

¹ Ibrahim Maalouf (1980) është një trombist, producent, aranzhues dhe kompozitor franko-libanez. Në vitin 2022 ai u bë instrumentisti i parë libanez i nominuar në Çmimet "Grammy" për albumin e tij "*Queen of Sheba*" në bashkëpunim me Angélique Kidjo.

e radhës do të studionte me detaje videon e regjistruar në kompjuterin e saj. Mendova se do të analizonte videon e hapësirës intime që po shikoja, e cila po më dërgohej si një letër pa fjalë, duke më shqetësuar më shumë se fakti që do ta dinte edhe dikush tjetër këtë lloj terapie të pazakontë. Kur Hekleri dhe Koh më kthyen në dhomën e gjumit, u zvarrita nën mbulesë dhe mendova për videon që po e këqyrte tani doktoresha Sibinoviq me metodat e veta mjekësore, duke i shndërruar imazhet e mia në diagrame, figura dhe vektorë. U mbulova me batanijen e grisur deri sipër kokës dhe qesha nga mendimi i parë se ajo nuk do të kapte dot as edhe një pjesë të asaj që dëgjova, nuk do ta kuptonte banderolën e grisur, do të përpiquej pa sukses të studionte degën që fshihi borën nga sipërorja e kamionit; për të britmat e fëmijëve do të interpretoheshin vetëm e thjesht si murmuritje çiliminjsh, kurse zilja e shkollës: thjesht një motiv prozaik nga lagjja. Gjithashtu, as që mund ta merrte me mend muzikën në *sfond* që dëgjova pas borës dhe as edhe në ëndrra, asnjë softuer nuk do të ishte në gjendje të përcaktonte me saktësi se ku ndodhej ai cep i botës. Ishte motel, shkollë, ndërtesë apo thjesht borë?! Tingëllonte si pyetje testi për patentën e shoferit: “Nëse jeni në një rrugë njëkahëshe dhe po vozisni me një makinë në terren të rrëshqitshëm, çfarë do të bëni përpara vendkalimit të këmbësorëve para godinës së shkollës, nëse grupi i nxënësve nuk i është afruar ende udhës për ta kaluar? Do të ngadalësoni shpejtësinë, do t’i bini borisë apo do të ndaloni menjëherë?” Doktoresha Sibinoviq me siguri do t’i shkarraviste të tria opsionet, por përgjigjja është se: para përfundimit të luftës, në këtë udhë ishte grisur tabela njëkahëshe dhe se ajo nuk u kthye më

kurrë në vendin e mëparshëm. Gjithashtu, emri i rrugës nuk ekzistonte më. Njerëzit pastaj filluan të ngasin nga të gjitha drejtimet, si t'u shkonte për mbarë, madje parkonin ngado, edhe atje ku nuk lejohej dhe ndaj fëmijët detyroheshin të lëviznin në rrugën për në shkollë mes makinave dhe kamionëve, në borë dhe akull, sikur të ishin duke rrëshqitur me ski në ndonjë sllallom gjigant mes flamujve.

Kemi luajtur disa herë në klubin e vogël “Q” përballë shkollës “Xhemail Mustafa”. Ndodhej në bodrumin e kolosit të vjetër të banesave socialiste, kishte dy hapësira, një holl me një banak dhe një skenë në hapësirën tjetër ngjitur pak më të madhe, të cilën pronari e kishte lyer me të zezë, sepse këtu ishin shfaqur për herë të parë pjesët e pasluftës dhe u zhvilluan debate, poetët kryenin ritualet e tyre; sikundër u zhvilluan edhe shumë ceremoni të ndryshme paqeje, shoqatat promovuan veprime civile jo të dhunshme. Një herë madje bëmë muzikën për shfaqjen “Rënia e Kullës së Pizës”, në të cilën një i ri i shëndoshë nga Jugosllavia u gjend në Sheshin e Mrekullive në Itali, çau gardhin përballë kullës, e cila në atë kohë ishte në rindërtim dhe u ngjit madje deri në majë të saj. Ai mori megafonin dhe nisi t'u thërriste qytetarëve të Pizës për t'u kërkuar të dinin se çfarë po ndodhte me vendin e tij. Po ndiqnim skenat e dialogut me njerëzit nën kullën që po përkulej gjithnjë e më shumë nën peshën e tij me kalimin e kohës, derisa djali përfundimisht nuk u shpall terrorist, sepse mu për shkak të tij ndërhyri policia, në fakt, e bëri shumë vonë, në kohën kur nga kulla kishte mbetur vetëm një grumbull gërmadhash, ashtu si dhe nga vetë koka e të riut. Për atë shfaqje me Nikun shkrova një kompozim shumëpjesësh, të quajtur “Kapriçio jugosllave”. E shfaqëm

në *real time* bashkë me një shfaqje të vogël teatrore të një trupe nga Zenica.

Klubi “Q” ishte dëngazi atë natë dhe ne luajtëm vërtet mirë. Publiku duartrokiti furishëm në fund, madje u kërkua që ne, së bashku me aktorët, të përkuleshim për nderim në skenë. I verbuar nga reflektori, as që e vura re kur m’u afrua Ena dhe më përqafoi pa kujdes, më pëshpëriti se kishte diçka të rëndësishme për të më treguar dhe u zhduk sakaq, pasi më futi një trëndafil në xhepin e këmbës. Qëndruam për ca kohë në rrënojat e teatrit të kullës të kapur për dore, ndërsa në mesin tonë brenda me një rrip në bel, me pantallona kamuflazhi dhe çizme ushtarake, qëndronte aktori që luante Kapriçon. Ai ngriti duart dhe nisi të na tërhiqte të gjithëve për ta ndjekur, si të ishim të lidhur me litar. Ishte krejt tapë atë mbrëmje. Dhe kur u ul perdja, të gjithë ia mbathëm, secili në kokë të vet. Atmosfera në bendin tonë ishte zhdukur dhe s’ishte si më parë. Grujiqi dhe Niku dolën për një birrë së bashku, Ivani zakonisht shkonte me Enën, ndërsa unë pjesën tjetër të mbrëmjes e kalova në lokal, duke parë marifetet e dehura të poetëve dhe aktorëve vendas. Në qendër të vëmendjes ishte zakonisht njeriu i Kapriçios, për të cilin roli ishte më i miri që kishte interpretuar ndonjëherë në jetë. Kishte qenë pjesëmarrës në luftë, por si ushtar i intendencës, siç na tha dhe përpiquej të sajonte argëtimin e luftëtarëve në Drenicë. Pas luftës udhëtoi nëpër ish-Jugosllavi dhe bëri recitime në teatro alternative. Më së shumti në Sarajevë, pastaj në Zenicë, ku u njoh me Enën dhe kur filloi bashkëpunimi ynë. Nuk e di se si kishte qenë para luftës apo nëse kish lindur kaq i dhjamosur, apo nëse ishin vitet e vështira që e shndërruan të tillë. Veçse,

ishte një nga të paktët njerëz që arriti ta përdorte masën trupore për qëllime të mira. Ai e përdori atë si rekuizitë teatri, interpretoi çfarë i shkoi ndër mend me të. Nganjëherë vishte kurora me lule në kthesat e sallës, ndonjëherë do të godiste dikë në stomak ose do t’ia vinte kokën mes sisëve të ngritura partneres. Qeshte me gjithë zemër dhe kurrë s’ndalonte së lëvizuri. Dhe nëse qëndronim në këmbë në fuaje, ai sërish hidhej me furi. Atë mbrëmje, Kapriçio performoi me një shkëlqim të plotë. Me një gotë mbi kokë interpretoi kërcimin e çuditshëm të barkut nga “*Lithium*” i Kurt Cobain, të cilin duhej ta bënte në fakt në fund të çdo shfaqjeje. Publiku e inkurajoi dhe i hidhte romuze, ndërkohë që ai po bëhej një virtuoz i vërtetë me gotën në kokë dhe po rrotullohej nëpër sallë me masat e dhjamta që përkonin me ritmin gjithnjë e më të shpejtë të këngës. Të kujtonte një perëndi pagane pylli, ndoshta Silenusin¹, i cili po shkelte me thundrat, si të ishte ndonjë ushtar teksa luante kërcimin e tij joshës. Nga diku prej turmës u shfaq Ena dhe filloi të kërcente me të, duke ia futur kofshën mes këmbëve. Ata dukeshin si çift që po luftonin për hapësirën e tyre. Kjo është arsyeja pse publiku u shty dhe u largua në mënyrë që ata të lëviznin lirshëm, të anoheshin nga njëri-tjetri, të zmbropseshin dhe të tërhiqeshin, derisa arritën deri në shkallët në dalje të klubit. Pastaj, sipas marrëveshjes, u hodhën lart, na e bënë me dorë dhe u zhdukën në errësirën e oborrit.

¹ (Mitologji) Silenusi është një figurë nga mitologjia greke, i njohur kryesisht si shoqëruesi dhe mësuesi i perëndisë së verës Dionis. Ai shpesh përshkruhet si një plak i gëzuar dhe i dehur, i lidhur me egërsinë e natyrës, verën dhe festimet.

“Nuk munde të përmbaheshe”, - i thashë Enës të nesërmen në mëngjes, kur m’u shfaq me syze të errëta në lobin e hotelit. Ajo u rrëzua e lodhur në kolltukun pranë meje. “Mos më pyet asgjë”, -tha, duke fërkuar gërvishtjen në gjurin që dilte nga e çara e xhinseve, tipi ishte i çuditshëm. “A është e mundur? - buzëqesha, - kush ta ka thënë këtë?” Ena u largua dhe në një çast ngriti syzet, m’u ngjit në fytyrë për të më përshfaqur nga fare afër rrathët e mëdhenj të syve. “Çfarë të ndodhi?” - e pyeta. “Ah, çfarë. Tipi më çoi në dhomën e hotelit, por më pas u kthyem aksidentalisht në një rrugë dhe shpejt u gjendëm te varrezat. Po, po, në varreza, mos më shiko ashtu...” Më pas Ena, mjaft e afërt me mua, më tregoi se si e kishte çuar në varrin e dikujt me një stol betoni anash, që duket se asaj po i kujtonte diçka. Ai ra mbi gjunjë dhe ia nguli kokën mes këmbëve. Qau duke iu lutur ta ndihmonte, sepse, siç i pohoi, nuk kish pasur ereksion qysh nga lufta dhe më pas e kuptoi krejt rastësisht se mund të shkonte vetëm në varreza për t’i bërë ato gjëra. “Ishte vërtet i shkarë”, - qeshi Ena ndërsa po ma tregonte. Pastaj mblodhi buzët sikur donte të më puthte, por shpejt u bë serioze. Ajo pranoi të lidhej madje me rrip në stol. Vetë akti i lidhjes e bëri atë të çmendej, ndërsa ai filloi të rrotullohej përreth saj si të ishte ndonjë grabitqar. Ia grisi rrobat dhe ia spërkati me yndyrën e fytyrës së tij, që i zbriste deri në mjekër. Koka e saj qëndronte e varur nga stoli ndërsa ai po depëronte brenda. Ajo pa hënën mbi qytetin e përmbysur, sa një pjatë darke në restorante të shtrenjta, siç e kishte parë dikur në udhëtimet që kish bërë me ish-burrin, mjeshtër aikidoje. Biftekët e gjatë dhe të përgjakur pulsonin ende në ato pjata kur t’i servirin. Ai zakonisht ia priste në copëza

të vogla, me lëvizje të sakta dhe të fokusuara, ndërsa ajo bënte një thertore gjaku dhe erëzash nga pjata me prerjet e saj. Në fund përfundonte në tualet dhe e nxirrte me të vjella për një kohë të gjatë. Të gjitha këto ia besoi Kapriçios, ndërsa ai nisi ta qinte si i luajtur mendsh. U deshën orë të tëra dhe, kur më në fund mbaroi, mbeti i shtrirë sipër, ashtu siç ishte bifteku i saj, i kafshuar që në fund, që as e vinte në gojë. Mezi arriti ta largonte nga vetja, pasi i çliroi duart nga rripi i liruar. Ai rrinte shtrirë pranë kokës së varrit të njëfarë Quosje, i cili kishte jetuar bajagi. “Kjo është toka jote, Kapriçio im”, - i tha ajo duke e fshirë spermën me një bluzë të grisur. Për fat të mirë, kur u kthye në hotel “Begolli”, askush nuk ishte në recepsion për ta parë në gjendjen ku ishte katandisur. “Dhe të gjitha këto i bëri për mua”, - shtoi në fund, e fshehur pas syzeve. I shtangur, e pyeta pse tha ashtu, por pasoi një përgjigje edhe më e pabesueshme: “Sepse dua të të ndihmoj, Filip. Që të të zgjoj. Je fundosur diku, i dashur. Ti më tremb...” Papritmas u shfaq Ivani me një çantë shpine, u afrua dhe e puthi Enën. Ai më hodhi diçka, një fjalë që dukej sikur tingëllonte “Shpresoj ta kemi thirrur në kohë furgonin” ose “Besoj se e rregulluam gjithçka për transportin”. Po, rregullova gjithçka dhe vetëm sa duhej të merrnim veten dhe të iknim nga ai qytet. Niku dhe Grujiqi kishin ngrënë mëngjes prej kohësh, po shëtisnin nëpër qytet dhe tashmë po na prisnin përballë hotelit. Kur mbërriti furgoni, hymë pa thënë asnjë fjalë, u shtrydhëm brenda dhe mjeti u nis përgjatë rrugës pranë shkollës dhe, më tej, duke kaluar monumentin e Klintonit vozitëm drejt daljes së qytetit.